


Pas gjetjes së *Mesharit*, imzot Skiroi «iu vu studimit të veprës së Buzuku me qëllim që të përgatiste një rishtypje, duke njoftuar për këtë gjetje të rëndësishme gazeta dhe periodikë të ndryshëm shqiptarë të kohës e duke botuar një artikull me germa të prera enkas, të ngjashme me ato të origjinalit». Lajmi pati jehonë të gjerë e qysh «në vitin 1929 françeskanët e Shkodrës porositën tri kopje fotografike», njëra prej të cilave u përdor nga Justin Rrota për botimin e disa pjesëve biblike që përmbante vepra, së pari, në revistën *Hylli i Dritës* të vitit 1930 e më vonë në një përmbledhje me titull *Monumenti më i vjetri i Gjuhës Shqype. D. Gjon Buzuku (1555)*.

Gjon Buzuku në Sicili: Pal Skiroi dhe studimi i parë filologjik i "Mesharit"

nga Matteo Mandalà



Shënime rreth librit "Pa pikë pa presje"
**MBAMENDJET E ARDIAN
NDRECËS SI DËSHMI E
NJË KOHE QYTETËSE TË
LINGATUEM**

nga Frano Kulli

(fq. 7)

Shënime për librin "Hijë në grila",
Eqrem Basha

FOTO TË ÇASTIT

nga Virion Graçi

(fq. 5)

Mbi romanin "Në Klubin e të shëmtuarve"
të Gëzim Aliut

**POETIKA E RRËFIMIT
TË FIGURSHËM**

nga Sali Bashota

(fq. 10)

"Sëmundja e ëndrrave – Trilogji për
vendlindjen" nga Mehmet Kraja

**"SËMUNDJA E ËNDRRAVE"
– HAKMARRJA E MITIT**

nga Ballsor Hoxha

(fq. 8)

Parathënia e librit të Bashkim Shehut, "Liri Belishova dhe
koha e saj - Idealizmi, humnerat e pushtetit, katarsis"

**LIRI BELISHOVA
DHE KOHA E SAJ**

nga Prof. Diana Kastrati

(fq. 17)



**SHKRIMTARI BËN LETËRSINË E
GJUHËS SË TIJ. PËRKTHYESI BËN
LETËRSINË BOTËRORE.**

RASTI MIRA MEKSI

Nga Bujar Hudhri

Shumë vite më parë, kur nisa botimin e veprës së plotë të Kadaresë, ndryshe nga ç'mund të jetë menduar, shkrimtari i lexoi të gjithë krijimet e tij nga e para, rresht më rresht. Një proces që zgjati gati pesë vjet dhe për një botues ishte një fat i rrallë që mund të takonte në rrugëtimin e tij ...

**SI U BOTUA
LIBRI IM I PARË**


nga Dimitër Shuteriqi

(fq. 9)

**MBI RRESHTIN E PARË
IKONIK TË "NJËQIND
VJET VETMI"**

Nga Claire Adam

(fq. 18)



BIBLIOTEKË

Besa Kalaja

Hijet

(fq. 13)

Andrin Kabashi

Balloja me maska

(fq. 14)

Marie Aubert

Më fal, më fal, më fal

(fq. 15)

Andreas Dushi

Shoku yt, Baba

(fq. 16)

Romani "Ulku dhe Uilli", i Vath Koreshit

**ANATOMIA E
SHPIRTRAVE TË
PERIFERISË**

nga Petrit Palushi

(fq. 12)

Pas gjetjes së *Mesharit*, imzot Skiroi «iu vu studimit të veprës së Buzuku me qëllim që të përgatiste një rishtypje, duke njoftuar për këtë gjetje të rëndësishme gazeta dhe periodikë të ndryshëm shqiptarë të kohës e duke botuar një artikull me germa të prera enkas, të ngjashme me ato të origjinalit». Lajmi pati jehonë të gjerë e qysh «në vitin 1929 françeskanët e Shkodrës porositën tri kopje fotografike», njëra prej të cilave u përdor nga Justin Rrota për botimin e disa pjesëve biblike që përmbante vepra, së pari, në revistën *Hylli i Dritës* të vitit 1930 e më vonë në një përmbledhje me titull *Monumenti më i vjetri i Gjuhës Shqype*. D. Gjon Buzuku (1555).

Gjon Buzuku në Sicili: Pal Skiroi dhe studimi i parë filologjik i *Mesharit*

nga Matteo Mandalà




imzot Zef Krispit (1781-1859), i cili jo vetëm që e citoi në veprën e tij *Memorie storiche su alcune costumanze delle colonie albanesi di Sicilia*, por botoi edhe tekstin e dy fragmenteve të *Mesharit* që kishte kopjuar Kazazi, transliteruar në alfabetin e shqipes që ai vetë kishte krijuar. Kështu, për herë të parë një pjesëz e *Mesharit* e pa dritën e botimit përmes një qasjeje, që, paçka se modeste nga pikëpamja metodologjike, përruronte udhën e gjatë të studimeve filologjike mbi veprën e Buzukut.

Ca kohë më pas imzot Pal Skiroi, peshkopi arbëresh i Sicilisë dhe rektor i seminarit që themeloi at Guxeta, pasi mësoi për ekzistencën e *Mesharit* përmes veprave të pararendësve të tij dhe natyrisht, përmes letrës së Kazazit, vendosi t'i jepte udhë një fushate të vërtetë kërkimesh në bibliotekat më të rëndësishme kishtarë të Romës. Imzot Skiroi i takon merita e “rizbulimit” të librit të Buzukut, e bashkë me të edhe të një morie dokumentesh të tjera gjuhësore me rëndësi të jashtëzakonshme, mes të cilave përmendim kopjen e shtypur të veprës së Matrangës “E mbsuame e krështerë” që u gjet në Bibliotekën e Vatikanit. Fushata kërkimore filloi aty nga viti 1909, kur imzot Skiroi mundi më në fund, falë edhe përkrahjes së kardinalit F. Ehrle që asokohe ishte prefekt i Bibliotekës së Vatikanit, të

Falë një vargu rrethanash fatlume Sicilisë dhe studiuesve më të shquar arbëreshë të kësaj ujdhesë u janë ndeshur udhët me çastet më të rëndësishme të historisë së monumentit më të vjetër gjuhësor të shqipes, *Mesharit* të Gjon Buzukut. Qysh prej zbulimit të kësaj vepre nga Kazazi dhe rizbulimit të mëvonshëm nga imzot Pal Skiroi (1866-1941), *Meshari* i Buzukut ka qenë në qendër të një interesimi të jashtëzakonshëm, që jo vetëm ka të bëjë me historinë kulturore të ngulimeve arbëreshe të Sicilisë, por ka frymëzuar dhe nxitur një lëmë të veçantë studimesh, atë ektotik, që zë fill me përpjekjet e para të propozimit të një teksti kritik të *Mesharit* dhe vijon deri në ditët tona me ndihmesën e vyer që po japin tashmë prej vitesh në fushën e filologjisë shqipe dy katedrat e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Palermo dhe në Kozencë.

Sikundër dihet, *Meshari* u zbulua për të parën herë aty nga viti 1743, kur imzot Gjon Pagëzues Kazazi (1702-1752), prej Gjakove, i sapoemëruar arkipeshkëv i Shkupit, teksa po kthehej nga një vizitë apostolike që kish kryer në Bullgari dhe në vende të tjera të Lindjes, e gjeti në Kolegjin e Propagandës

Fide dhe vendosi të njoftojë menjëherë përmes një letre at Gjergj Guxetën (1682-1756), rektorin e Seminarit Arbëresh të Palermos dhe nismëtarin e një lëvizjeje të rëndësishme politiko-kulturore ndër arbëreshët e Italisë. Letra e Kazazit, që deri para vitit 1967 ruhej në arkivin e seminarit, ndërsa tani ndodhet në fondin *Albansk Samling* të Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagës, përmbante, me gjasa, edhe një relacion ku informohej at Guxeta mbi kushtet në të cilat dergjej popullsia shqiptare e besimit katolik në viset e Ballkanit, që prej kohësh ishte pushtuar nga osmanët dhe vuante nën një shtypje fetare dhe kulturore të pashoqe deri asokohe. Ky relacion nuk ndodhet më në arkivin e seminarit. Gjithsesi ekzistenca e tij është dokumentuar qoftë nga Pal Maria Parrino (1710-1765), qoftë edhe nga Nikollë Keta (1742-1803), të cilët e citojnë në veprat e tyre të titulluara përkatësisht: “*In septem perpetuae consensionis libros septem Albanensis Ecclesiae cum Romana omnium Mater et Magistra*” dhe “*Tesoro di notizie su de' Macedoni*”. U desh të kalonte pothuaj një shekull që letra e Kazazit, harruar në raftet e arkivit, të shpluhurosej dhe të tërhiqte vëmendjen e




Zarfi dhe f. 1 e letrës qrakore të imzot P. Skiroit (1922)

shqyrtonte librat e shumtë të pakataloguar që vinin nga biblioteka të tjera. Mes këtyre ishte edhe kopja e *Mesharit* që në kohën e Kazazit ruhej në Bibliotekën e Propagandës, por që pas vitit 1900, me unifikimin dhe përqendrimin e fondeve të ndryshme kishtarë që ndërmori Selia e Shenjtë, u transferua në Bibliotekën e Vatikanit.

Historisë së vendndodhjeve të ndryshme të *Mesharit* në rrjedhë të shekujve nuk i është kushtuar rëndësia e duhur. Ndoshta te kjo shkujdesje zë fill hipoteza sipas të cilës vepra e Buzikut ra viktimë e censurës pastridentine dhe u fut në listën e librave të ndaluar (*Index librorum prohibitorum*). Sipas kësaj hipoteze, fakti që kopja e vetme e *Mesharit* u gjend në Bibliotekën e Vatikanit, dëshmon se, me gjasa, vepra, pasi i është nënshtruar zyrës së censurës së Vatikanit, do të jetë gjykuar si e papajtueshme me udhëzimet e koncilin e, për këtë arsye, do të jetë ndaluar dhe tërhequr nga qarkullimi. Kjo hipotezë ka disa të meta. Së pari, fakti se kopja e gjetur ka përanash faqeve shënime të shumta apografe të bën të mendosh për një interpretim kryekëput të kundërt, sepse dëshmon jo vetëm për një përdorim praktik të *Mesharit*, por edhe për qarkullimin e kësaj vepre në trojet e Ballkanit. Së dyti, falë një studimi të botuar këto kohët e fundit nga Lucia Nadin, tashmë dimë se libri i Buzikut u shtyp në Venecia (shih Lucia Nadin *Shqipëria e rigjetur – zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në shek. XVI*, Onufri, Tiranë, 2012, f. 230-325), mirëpo në botimet e shumta të *Index-it* nuk përmendet asnjë *Mesha* në gjuhën shqipe i shtypur në Venecia, prandaj bie hipoteza që libri i Buzikut të ketë qarkulluar jashtë mjediseve ballkanike dhe shtohen gjasat që autoritetet e Vatikanit të jenë vënë në dijeni të ekzistencës së *Mesharit* vetëm përmes së vetmes kopje të shtypur që mbërriti në Romë.

Pas gjetjes së *Mesharit*, imzot Skiroi «iu vu studimit të veprës së Buzuku me qëllim që të përgatiste një rishtypje, duke njoftuar për këtë gjetje të rëndësishme gazeta dhe periodikë të ndryshëm shqiptarë të kohës e duke botuar një artikull me germa të prera enkas, të ngjashme me ato të origjinalit». Lajmi pati jehonë të gjerë e qysh «në vitin 1929 françeskanët e Shkodrës porositën tri kopje fotografike», njëra prej të cilave u përdor nga Justin Rrota për botimin e disa pjesëve biblike që përmbante vepra, së pari, në revistën *Hylli i Dritës* të vitit 1930 e më vonë në një përmbledhje me titull *Monumenti më i vjetri i Gjuhës Shqype. D. Gjon Buzuku (1555)*. Ndërkohë mbeti i pabotuar studimi i përgatitur nga imzot Skiroi, i cili nuk mundi t'i kapërcente vështirësitë e ndryshme që hasi për botimin e studimit të





Imzot Gjon Pagëzues Kazazi, *Letër At Gjergj Guxetës, Albansk Samling*, Biblioteka Mbretërore e Kopenhagës, f. 1r

plotë filologjik. Nëse lëmë mënjane botimin kritik të «pjesëve biblike të Buzikut», përgatitur nga bashkëpunëtori i Skiroit, Gaetano Petrotta (1882-1952) për periodikun shkencor “Rivista indo-greco-iranica di filologia, lingua e antichità” me titull “Il più antico testo di lingua albanese: Gjon Buzuku (1555)”, studimi filologjik i gjerë dhe i hollësishëm i zbuluesit të *Mesharit* ka mbetur thuasjse krejt i panjohur për botën shkencore albanologjike. Kohët e fundit m'u dha rasti t'i hedh një sy veprës së pabotuar të imzot Skiroit, që ruhet me kujdes e dashuri të veçantë nga trashëgimtarët e studiuesit arbëresh e veçanërisht nga stërnipi, Franko Skiroi, të cilin me këtë rast e falënderoj për zemërsisht për ndihmën që më dha në fthillinim e vandakëve të pafundmë me dokumente të arkivit privat që ai ruan me përkushtim të madh.

Nuk është vendi këtu të bëjmë një përshkrim të hollësishëm të studimit të imzot Skiroit. Gjithsesi, nuk mund të mos theksojmë se megjithëse shumë aspekte të kritikës tekstore që shfaqen në këtë

studim të rëndësishëm janë kapërcyer tashmë nga studimet e mëvonshme të zhvilluara gjatë shekullit të shkuar, kjo vepër përbën sot një ndihmesë të vyer për historinë e kritikës tekstore buzukiane, madje, do të thoshim, për historinë e asaj disipline për të cilën Eqrem Çabej ëndërronte një të ardhme më të ndritur, duke i përkushtuar një nga punët e tij më të mira: pikërisht botimin kritik të *Mesharit*.

Ekzistenca e dorëshkrimit të pabotuar me studimin e vëllimshëm të imzot Skiroit u bë e ditur së pari prej të nipit, Zef Skiroit, i cili e dha lajmin në një jetëshkrim interesant mbi të ungjin e shquar. Studimi “i thellë” i imzot Skiroit mban titullin “I testi biblici in lingua albanese di dom. Gjon Buzuku, messi in ordine, con traduzione italiana e note” dhe përfshin qindra fletë dorëshkrim të mbledhura në tre fashikuj të trashë. Kjo vepër është fryt i “një pune dhjetërvjeçare”, që përmbledh përpjekjet për të dhënë një interpretim fonetik të gjuhës së Buzikut përmes një krahasimi të imët me të dhënat



Imzot Pal Skiroi, faqe nga botimi kritik i Mesharit


gjuhësore të nxjerra nga veprat e Matrangës, Budit, Bardhit e Bogdanit.

Botimi i pjesshëm që përgatiti Gaetano Petrotta jep vetëm një ide të përciptë të punës së madhe që kreu mësuesi i tij. Pjesët biblike që u botuan në riprodhim diplomatik dhe në transkriptim fonetik, megjithëse dëshmonin një metodë pune që më vonë do të imitohej edhe nga Çabej, në fakt përbënin vetëm një paraqitje të pjesshme të praktikës ekdotike të ndërlikuar që përmban studimi i pabotuar. Nisur nga hamendja se grafia e Mesharit paraqiste tipare johomogjene dhe zgjedhje alfabetike që nuk kishin lidhje me traditën tipografike perëndimore, Skiroi vendosi të vinte përkrah transkriptimit normal të tekstit, edhe një riprodhim në kufijtë e besnikërisë mekanike që sot sigurohet vetëm nga makinat, përmes një rishkrimi diplomatik të tekstit.


Përpjekja për të riprodhuar besnikërisht tiparet grafike bazohet në bindjen se disa nga zgjedhjet e ndryshme alfabetike të Buzukut përbënin vështirësi që e ndërlikonin interpretimin kritik. Në fakt, disa raste, si fjala vjen, e ashtuquajtura "h irracionale", ishin asokohe të pazgjydhshme, sikundër janë edhe sot e gjithë ditën. Ndoshta pikërisht ky impostim ekdotik përbënte pengesën kryesore për botimin e veprës. Asokohe ishte e pamundur të gjendeshin shtypshkronja të afta të riprodhonin besnikërisht tekstin e Buzukut dhe të përballonin një punë të përmasave të tilla që përfshinte përveç riprodhimit diplomatik, transkriptimit fonetik dhe riprodhimit të originalit latinisht, edhe një aparat kritik që përmbledhte rezultatet më të mira të studimit. Nuk e teprojmë po të themi se metoda që ndoqi Skiroi në aparatin kritik edhe sot pas afro një shekulli përbën një model të vlefshëm që mund të përdoret krahas atyre që sot përdoren në filologjinë shqipe.

Me të mbaruar punën filologjike me tekstin, imzot Pal Skiroi u përpoq të gjente botues për veprën. Sipas të dhënave që përmban një letër qarkore e cila është shtypur me kokën e fletores së

njohur *Fiála e t'In' Zóti*, studiuesi i shquar arbëresh hartoi një program që parashikonte botimin e librit të Buzukut në «një vëllum si 400 fákjesh, i çtëli dót kët pæræshkrimin e téstit me abetárin t'ænæ è tæ kæthiemen italishte. Kætij vëllumi dót i shtënonen edhe fototipit e gjithë téstit tçæ u gjent, tæ çtëllat jánæ një kjint n'kátræ shtylash». Imzot Skiroi ua dërgoi shumë vetëve këtë thirrje, përfshirë disa personalitete të shquara të kulturës dhe të politikës shqiptare. Një kopje e letrës, që ma vuri në dispozicion bujarisht miku dhe kolegu erudit prof. Aurel Plasari, të cilin përfitoj nga rasti për ta felënderuar, është gjetur në një zarf që mban datën 3 maj 1922, drejtuar Mid'hat Frashërit (1880-1949) që asokohe banonte përkohësisht në Hotel Byron në Paris. Për fat të keq projekti ambicioz i imzot Skiroit nuk u realizua dhe studimi i tij kritik i Mesharit do të priste një shekull para se të rikthehej në vëmendjen e studiuesve. Edhe për këtë arsye nuk mund të mos përfitoj nga rasti për të ftuar institucionet publike ose private shqiptare të marrin përsipër barrën dhe nderin e botimit të atij që sot mund ta quaj me plot gojën, nga njëra anë, studimi filologjik sa pionieristik, aq edhe risor i Mesharit e, nga ana tjetër, vepra që përruron filologjinë moderne shqiptare. Për sa u përket trashëgimtarëve të imzot Skiroit, në veçanti të lartpërmendurit Franko Skiroi, një nismë e tillë botuese do të jetë jo vetëm shenjë dhe dëshmi e frymës së bashkëpunimit me gjysmën tjetër të qiellit arbëresh, por do të konfirmojë edhe një herë, a thua se vërtet është nevoja, rolin shkencor që imzot Pal Skiroi pati në suazën e historisë së studimeve mbi Mesharin e Buzukut. Në qoftë se, sikundër shpresoj, kjo ftesë do të mirëpritet, marrëdhëniet arbëresho-shqiptare do të fitojnë, në përgjithësi, një statuat bashkëpunimi më të frytshëm dhe do të hyjnë, në veçanti, në historinë e njërit prej lëmenjve vendimtarë albanologjikë. Me siguri do të plotësojnë dëshirën e papërmbushur të themeluesit të filologjisë moderne mbarë shqiptare.



Faqe studimore e imzot Pal Skiroit me bashkërkime latino-shqipe të Mesharit



Faqe e apartit kritik të Mesharit me shënimet e imzot Pal Skiroit për botuesin

Shënime për librin “Hijë në grila”, Eqrem Basha

FOTO TË ÇASTIT

nga Virion Graçi

Veprimtaria letrare/krijuese e Eqrem Bashës, e pa ndërprerë në Kosovë për disa dhjetëvjeçarë, nuk ka qenë e tillë në lidhje me editorinë në Shqipëri. Si për të ndrequr një padrejtësi a pakujdesi të rrethanave ai vjen këto kohë me përmbledhjen me tregime “Hijë në grila” (Botimet Onufri, 2020). Libri mban një emër që nuk i përket ndonjëerit nga tregimet, sikurse ndodh rëndom, dhe kjo nuk është e rastit, besoj. Tregimet janë pagëzuar me emër të parbashkët, libri është strukturuar me arkitekturë të mirmenduar, me koncept e fizionomi përafruese si roman; si pjesë të zgjedhura të të njëjtit roman janë 12 tregimet e sistemuar në tre kuartet (kuartet i quaj këtu, për shkak se janë nga katër) të cilëve u prin tregimi prolog “Vetëm një natë”.

Kuarteti PARKU I ZEMRËS me tregimet: “Dy pleq në një romancë”; “Balada e Kopështarit”; “Parku i zemrës” dhe “E ftohtë si të tjerat” ka pamje, fokusime të jetës qytetëse. Natyrisht, janë proza minimaliste, me pak ose aspak ngjarje/histori, eksursione psikologjike nëpër vetëdijen e një njeriu ose mes dy tipave të periferisë, heronj vogëlsish.

Jeta si e tillë nis të shtjellohet nga stacioni i fundit, në përfundim të saj; dy të moshuar, të braktisur nga çdokush, nga të afërmit dhe nga strukturat mbështetëse sociale, duke pritur të shohin tjetër frymor veç vetjeve të tyre, duke pritur furnizimet ushqimore, larg vendbanimeve të mbipopulluara, e hedhin dorën në pasurinë e fundit që ju ka ngelur, në rininë e tyre, në kujtimet nga muaji i mjalit, në çastet dashurore kur trupat e tyre njomëzakë ndizeshin flakë, kur shëndeti rinor i përgjigjej erosit dhe jeta shoqërore ishte ndryshe, ishte më e gjallë, me njerëz e pa mungesa materiale. Kontrasti mes preludit dhe përfundimit të jetës në çift krijon tension dramatik dhe konflikt mes heronjve; gjenden të dy të vdekur pas disa ditësh, për arsye të pa qarta. Autori, nëpërmjet mënyrës mjeshtërore të zhbërimit e zbërthimit psikologjik të tyre, nëpërmjet dialogut efikas na mundëson të hamendësojmë se dhe jeta e përbashkët intime mund të ripërfetohet e ritregohet në mënyra krejt të ndryshme prej partnerëve; e tashmja e atrofizuar e mungesore çon në kundërtënie edhe sa u përket kujtimeve të njëjta; pritshmëritë e pa përmbushura nga dobësia e moshës dhe zvetëinimi i kujdesit shoqëror, mund të vrasin secilin prej tyre, mund të shkaktojnë konflikt shkaatërrimtar. Përafrimi në një sekuencë kohore i skajeve ekstremë të jetës së individit, duke e marrë një burrë e një grua nga lumturia e madhe deri në palumturinë e thellë, duke i vizatuar ata me penelata të shpejta, të kursyera nga rinia në pleqërinë e thellë dhe vdekjen e sigurt, E. Basha e bën sintezën artistike të njerëzisë në përgjithësi, e zbardh spektrin jetësor të njerëzimit të sotmë.

Tregimi vijues (“Balada...”), ndonëse tregim i kryer në vetvete, si në një sekuencë kinematografike vazhdon ‘reportazhin’ nga e njëjta hapësirë, duke ju afuar qendrës së qytetit: tani meditohej për të buurën, për bukurinë e humbur në kuptimin e dyfishtë të fjalës: si funksion bio-ekologjik dhe si zeje estetike-njerëzore, e kryer dikur nga një njeri pa emër të veçantë, mjeshtër në pemtarinë dhe bimësinë dekorative. Përshkrimi i çdo luleje dhe peme dekorative, bërë me saktësinë dhe ëndjen e një botanisti të mirëfilltë e bën rrëfimin alegorik dhe pasqyrë të trishtë, gati vajtim për një parajsë urbane të humbur, të zhdukur; një parajsë për tokësorët e cila, për të ekzistuar, nuk kërkon njerëz të virtytyshëm, në kuptimin fetar të fjalës, as larje mëkatesh, as shpagë fajesh e borxhesh në paradhomat e përjetësisë; ishte parajsë e mbritëshme për çdo banor qyteti e qyteze shqiptare, kërkon veç një njeri, një bahçevan, i cili kush e di në cilën epokë mund

të rishfaqet përsëri ndër ne. ndërkohë, në mungesë të bukurisë, pemët, shkurret, barat, kafshët e egra e insektet e gllabërojnë ngadalësisht periferinë dhe zermën e qytetit.

Teksa kthehet në parkun aktual, në tregimin e radhës E. Basha sjell në dialog, në kufijtë e teatrit absurd dy njerëz që kanë mësymur kryeqytetin si banorë rishtarë dhe kanë harruar veten, të afërmit, të shkuarën, identitetin e tyre. Një kacafytje pyetje-përgjigjesh të pa shpresa dhe, mbi të gjitha, pa edukatë mes të panjohurish në park, bëhet zbuluese për personazhet, na i sjell ata si kategori tipike/shoqërore, ndonëse, në vetvete, sa më tepër japin e kërkojnë informacion të ndërsjelltë, aq më konfuzë e pa identitet ngelen.

Afresk i përditshmërisë sonë është tregimi: “E ftohtë si gjithë të tjerat”; me gjasë sikur jemi duke lexuar një tregim të N. Gogolit: një ekonomist i pensionuar, në ditët e ndalim-qarkullimit të pandemisë ka dalë ndër klientët e tij modestë si këpucarë, furrrxhinj, druvarë të mbledhë të dhënat e tyre të biznesit, t’i ndihmojë të bëjnë bilancet vjetore për zyrat e shtetit, meqë është ‘specialist i llogarive përmbyllëse të bizneseve të vogla dhe veprimtarive shërbyese’. Përfundon i ndaluar nga forcat policore, i keqtrajtuar, i dërguar në paraburgim si element i rrezikshëm, e aty jep shpirt, në dhomën e paraburgimit, si një i ndaluar pa emër; prej ngutit, forcat policore nuk ia kanë shënuar emrin, kanë dalë nëpër qytet të gjejnë të trajtojnë ngjashëm si specialistin e llogarive përmbyllëse, edhe të tjerë si ai. Citoj: *Në raportin pa pikë pa presje që kishin lënë rojat e shëndetit në stacionin e vogël policor kishte shumë të paqarta: më datën 28 janar në orën pesë të mëngjesit personi në fjalë (duket as për emrin nuk kishin arritur ta pyesnin) i zënë në flagrancë në kohën kur ishte ndaluar qarkullimi jo vetëm nuk iu bind urdhërave të ndalesës për të ofruar vërtetim për qarkullim në masa karantine por iu shmang ndalesës dhe nisi të largohej me ike nga vendi nga vendi i flagrancës duke kundërshtuar me forcë andaj*



është arrestuar dhe ndaj tij duhet të ngrihet procedura e rregullt për kundërshtim të dhënies së shënimeve të nevojëshme personit zyrtar. (f.68-69)

Ngjarjet vendosen në ditët e para të pandemisë dhe kyçjes planetare për t’u shpëtuar pasojave të gripit, por nëpërmjet titullit “E ftohtë si gjithë të tjerat” autori e bën përgjithësimin, e shndërron në shëmbëlltyrë të krejt jetës sonë, e njëjta histori që përsëritet e riciklohet në mënyrë tragjiko-komike, edhe në mungesë të epidemive globale.

Kuarteti PËRMBARIMI me tregimet: “Brohoritjet e çastit”; “Agjencia e përmbarimit”; “Kalendari” dhe “Varri i çelësit” shquhet për realizëm psikologjik, pa rënë në psikologjizëm. I pari bën arkeologjinë e një mendjeve të përgjumur nga qëndrimi nën diell, arkeologji që në kohë paqësore tregon shtresëzimet në vetëdijen e tij; pushkët që i janë drejtuar dikur për ta vrarë kanë ngelur përjetësisht të ngulura në trurin e tij, të drejtura nga ai më të njëjtin synim dhe efekt. Kjo tufëz tregimesh na e heq mundësinë e nevojën për t’iu qasur një fabule-bazë, për ta shqiptuar atë. Nëse vendingjarjet dhe personat tregues I njohëm gradualisht në tregimet e mëparshëm, te ky kuartet dalin në sipërfaqe motive/shqetësime të natyrës filozofike-ekzistencialiste, realizuar poetikisht, me gjetje interesante.

Kuarteti HIJE me: “Gjarpër”; “Duel”; “Varri i Askujt” dhe “Fytyra në grilat e derës që nuk hapet” na jep një narrator të dalë nga fusha e lojës trilluese duke ia lënë radhën autorit; autori shfaqet si i tillë, heq dorë nga zëdhënësit e tij fiksionalë, me tone të drejtpërdrejta bisedore dialogon me lexuesin për temën që ka ndërmend të shkruajë e për anakronizmat dhe mit-temat e rrejshe që e formësojnë dhe deformojnë ndërgjegjen kolektive, e dekonstruktojnë bartësin sado i vetmuar a i kolektivizuar qoftë ai në turmën e madhe.

Tregimi i fundit “Fytyra në grilat...” (f.162-172) e ka të kristalizuar strukturën fabulore: një fotograf amator përpiket të fotografojë gjithmonë e më qartë një Plakë e cila rri mbështetur përditë në grilën e derës që nuk hapet kurrë, me shikim tretur nga rruga që nuk përdoret prej kalimtarëve. Do ta fotografojë për të lënë mbresa në rrethin e ngushtë shoqëror. Plaka paska vdekur në atë pozicion, Plaka bëhet pjesë e kureshtjes së përgjithëshme të kriminalistikës e mediave, kurse fotografi i kthehet normalitetit, sjelljes *trendy*, ndërron disa telefona, fshin pamjet, ndërron rrugë e mendësi, bëhet përqeshës i atyre që si ai për Plakën dikur, janë kureshtarë për njerëz të vetmuar të periferisë urbane.

Simbolikisht ky tregim ndërlidhet me tregimin-prolog “Vetëm një natë” (f.7-19) në të cilin jepet loja e mbrapshtë e ndarjes së njerëzimit në dy lloje: *të gjetur e të ardhur*; ironikisht, pas një nate të kaluar në shtrojat përdhese të hanit endacaku, *i ardhuri* bëhet *i gjetur*; *i gjeturi* në shtrojat e leckosura të hanit, i detyruar t’i lërë përkohësisht shtrojat për gjuetinë e rastit, në mëngjes ka humbur statusin e privilegjuar si *i gjetur*, dhe shndërrohet në *i ardhur*. Nga kjo largësi mitike me bujtësit e hanit, deri te tëhuajësimi modern ku përmbillet qarku tregimtar i E. Bashës, shtrihen e gërshetohen motive e mendime të fuqishme, gati të pa dukshme në pafajësinë e tyre, por esenciale, estetikisht të arrira, rrëmbyese.

...p.s.: për të saktësuar kujtesën, pas leximit të “Hijë në grila” ju hodha një sy titujve të rreth 35 kumtimeve e referateve shkencore të mbajtura para ca kohësh në një institucion shtetëror të studimeve albanologjike me temë ‘Tregimi në letërsinë shqipe’; i dëshmuar si tregimtar qysh në v.1971 (“Shëtitje nëpër mjegull”) E. Basha nuk ishte objekt trajtimi në ndonjë punim, nga asnjë kumtues-referues. Nga ana tjetër, botuesi në greqisht e kryeredaktori i një antologjie voluminoze me tregime nga shkrimtarët më të dalluar të Ballkanit, më njoftonte shoqërisht nga Thesaloniki se tregimi me të cilin përfaqësohej zoti E. Basha, ishte ndër më të mirët, mes të përzgjedhurve. Edhe unë, (v.g) i shkruaj këto radhë për “Hijë në grila”, me bindjen se është një kulm në historinë e tregimit shqiptar, pikë referimi në prozën e shkurtër bashkëkohore, si kundër kanë qenë të tilla në kohën e tyre, fjala vjen, “Hija e maleve”, “Tregtar flamujsh” e “Pasqyrat e Narçizit” të E. Koliqit.

SHKRIMTARI BËN LETËRSINË E GJUHËS SË TIJ. PËRKTHYESI BËN LETËRSINË BOTËRORE. RASTI MIRA MEKSI

nga Bujar Hudhri

Shumë vjet më parë, kur nisa botimin e veprës së plotë të Kadaresë, ndryshe nga ç'mund të jetë menduar, shkrimtari i lexoi të gjitha krijimet e tij nga e para, rresht më rresht. Një proces që zgjati gati pesë vjet dhe për një botues ishte një fat i rrallë që mund të takonte në rrugëtimin e tij të përditshëm. E gjithë trashëgimia letrare e shkrimtari tonë të madh u përmbledh në njëzet vëllime dhe ai e quajti si botimin e tij testamentor, në dallim me tri përmbledhjet e tjera ("Rilindja", Prishtinë, 1980, "Naim Frashëri", Tiranë, 1981 dhe "Fayard", 1993, Paris).

Nuk kaloi shumë kohë, kur Kadare më dorëzoi një dosje (ai shkruan ende me dorë, nuk e përdor kompjuterin) me dorëshkrimin e një romani të ri me titull "Darka e gabuar". E lexova me një frymë dhe s'di pse më solli ndërmend romanin e tij të famshëm "Kronikë në gur". Isha i sigurt, kurrë nuk do ta kishte shkruar këtë libër, nëse nuk do të kishte rilexuar "Kronikën", kur po përgatisnim veprën e plotë. Ia thashë këtë, por si përgjigje mora prej tij vetëm një buzëqeshje të papërcaktuar. Ndoshta as ai vetë nuk e dinte pikërisht, mbase hamendësimi im ishte thjesht një perceptim i gabuar prej lexuesi. Ku i dihet?

Po këtë ndjesi përjetova kur Mira Meksi më dorëzoi për botim tregimet e saj që në përmbledhjen e fundit morën titullin "Flutura mes gjinjve". Pak a shumë si në rastin e kolanës Kadare, me Mira Meksën më ndodhi po e njëjta histori. Mira sapo kishte përfunduar përkthimin e kryeveprës "Njëqind vjet vetmi". Nuk ka dyshim që gjithë ajo punë skrupuloze ka ndikuar në procesin e saj krijues si shkrimtare. Ishte një aksion që zgjati pothuaj tre vjet përkthim - redaktim. Kam qenë redaktori i këtij përkthimi dhe e kam krahasuar, rresht për rresht, me shumë gjuhë të huaja. E gjitha kjo dëshmohej në e maillet e shkëmbyera me Meksën. Ishte si një magji. Dhe mund të them me bindjen më të plotë se versioni në shqip i këtij romani është ndër më korrektët në raport me gjuhët e tjera. Për mrekullinë e përkthimit nuk më takon mua të shprehem, por ia lë lexuesit të gjykojë.

Por le të kthehemi te Mira Meksi. Emri i saj u bë shumë i njohur që para vitit 1990 me një tjetër kryevepër të Marquez, me romanin "Dashuria në kohërat e kolerës". Një libër i cili u shit me një tirazh të madh edhe për atë kohë. Kur para njëzet e pesë vjetësh më solli për botim librin e saj me tregime "Buzë të panjohura gruaje", ende nuk e perceptoja si autore, sepse figura e përkthyeses Mira Meksi ishte e identifikuar tashmë me Marquezin. Ndërkohë vijuan librat e tjerë të saj si "Frosina e Janinës", "E kuqja e demave" (një bestseller i vërtetë), libri eseistik "Leximet e ndaluara dhe shkrimet e fshehura" dhe sidomos revista e saj e cila la gjurmë të pashlyeshme te lexuesi shqiptar "Mehr licht", deri te dy romanet e saj si "Mallkimi i Priftëreshave të Ilirisë" dhe sidomos, kryevepra e saj, "Diktatori në kryq".

Shpeshherë ia kam bërë pyetjen vetes se çfarë është më shumë Mira Meksi: përkthyes apo

shkrimtare? Kur flas në intervista apo biseda të ndryshme e kam ndier shpesh këtë gjendje të papërcaktuar. Me një fjalë, ku duhet ta rreshtojmë: te lista e përkthyesve më të mirë apo lista e shkrimtarëve më të mirë? Dhe përgjigja gjithmonë më kujtonte shprehjen e famshme të Petro Nini Luarasit kur një nxënës e pyeti se "cili është më i zoti, Naimi apo Samiu?" dhe ai iu përgjigj: "Nga cili sy sheh ti më mirë, nga i djathti apo i majti?" Po ashtu, më vjen në mendje emri i Mitrush Kutelit, i cili ka bërë përkthime nga më të mrekullueshmet në gjuhën shqipe, sikundër ka lënë faqe brilante si shkrimtar. Ka plot shembuj të tillë, jo vetëm në kulturën tonë por në çdo gjuhë (psh., Shiler, Pasternak kanë përkthyer Shekspirin por ata janë autorë të famshëm të gjuhëve të tyre, ndërkohë). Për kronologji ne e njohim Mira Meksën fillimisht si përkthyes të klasit të parë të kryeveprave botërore, që ishin një nevojë e ngutshme për lexuesin e pas nëntëdhjetës. (Sikundër ka përkthyer nga shqipja në gjuhë të huaj.) Por me kohë ajo nisi karrierën e saj me tregime, novela, romane duke i shtuar letërsisë shqipe një zë krejt të veçantë, origjinal.

Nobelisti portugez Jose Saramago thotë diku: "Shkrimtarët bëjnë letërsinë e gjuhës së tyre. Përkthyesit bëjnë letërsinë botërore". E veçanta e Mira Meksit është se ajo i bën të dyja dhe kjo i jep një bukuri të veçantë letërsisë dhe të mahnit me përkthimet e saj.

Sepse Mira Meksi përpara se të jetë përkthyes është shkrimtare. Dhe ka qenë e tillë, që nga fillimi i jetës së saj, por lexuesit iu desh kohë që pas kryeveprave të Marquez, Borges, Dumas etj., etj., si një Hirushe të dallonte shkrimtaren Mira Meksi.



Filli i mbamendjeve, në librin e sapodalë, të Ardian Ndrecës nis në rrugicën e vet në Shkoder. Rrugica *me erë myshkut, me erë gjellësh me të velë, me erë lulesh e me erë tingujsh*. Asht njena prej rrugicave të Shkodres. Në fillimin e viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluëm. Era e myshkut të vjerrun muresh, si peisazh i pezulluem, i shpërfillun e i lanë mbas dore, era e gjellëve me të velë, si gjendje e vobektë e jetesës hjekakeqe e të neveritshme. Kurse era e luleve dhe era e tingujve përkundruall, si filad mbas zhegut zhuritës, si limfa që lidh e ushqen qelizat e jetës së mpime qytetëse. Ai langu gjallnues që ndërlidh segmente të njimbasnjishme të zigzakut të saj, ulje zbritjet e shformueme edhe kur rrugëtimi i saj asht në zgript.¹

Qysh në krye të herës, tue sjellë të vizatueme rrugicën e fëminisë së vet autori ngul një gozhdë ku lexuesi mundet me lidh për të fillin e leximit, e masandej nuk i dahet, por e ndjek këtë fill me të shpejtë, me shumë dëshirë e kureshtí. Se leximi akt kurreshtijet e dëshiret asht...

Kur më paten ra në dorë kujtimet e Simon Rrotës "Po shkruaj për vedi ...", më qe ngulë ma thellë në vetëdije kërkesa e unshme që ka leximi, po edhe ma përtej, vetë kultura e vetë qyteti, për mbamendjet e shkrueme. Një shkak i fortë ka qenë, besoj unë, mirëpritja befasuese e librit me kujtime nga jeta qytetse e piktorit, themeluesit të shkollës së këtij "harti" në Shqipëri, ardhur prej një shkollimi shumë të mirë nga Akademia "Brera" e Arteve të Bukura të Milanos. Ndoshta shllirësia mahnitëse e ndershmënia e dallueshme e rrëfimit janë gravitacioni që lexuesin e ban me i përthithë me një hurm ato. Vetë mjeshtri i "hartit" i kishte mbyllë sytë, prarue në bindjen e thellë se gjithçka që kishte lanë të shkrueme do të ishte asgja ma tepër se një tubë kujtimesh të tijat, për të afermit e vet. Kujtimet përreth qytetit të tij të lindjes e të vdekjes. Dhe kaq.

Mirëpritja që i ra me qenë me të vërtetë një surprizë edhe për lexues genuinë të qytetit e ma përtej, por edhe për të tjerë ma të afërt në kohë me kujtimet e librit të piktorit, ka ndodhë gati 60 vjet mbasi ato ishin shkruar...

Ardian Ndreca, me librin "Pa pikë pa presje" të mbamendjeve të veta na ban një ftesë dashamire për me vizitue një tjetër kohë, atë të 40-50 vjetëve të shkueme; një kohe e lingatueme keqas prej rropullisë ku ishim gjindë pa dashjen e vullnetin tonë. Dhe, mua, përmbas leximit të mbamendjeve të shkrueme me sqimë, më duket se ja ka mbërrit me na e sjellë këtë copë kohë me të dukshmet e të nenkuptueshmet e saj, me tragjiken e saj e me komiken gjithashtu... Tash qyteti e kishte të skicueme mirë silueten "e re". Bexhisteni i famshem me rreshtin e 1500 dugájve [dyqane, njësi tregtare], pa numrue agjensitë tregtare e zyrtat doganore, ishte rrafshu e tregu ishte transefue ma nalt në verilindje të qytetit. Si një tjetër pazar, që të vetmin ndryshim për mirë kishte sjellë ndrrimin e emnit të parë me etimologji turke me një tjetër emen të pa emen - **fushë**, që me siguri ka dashtë me përcaktue vendtregtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale të katundit. Aty mund të shifshë shllakas të vujtun me ndonji barrë qymyr...po edhe gra zadrimore të hijshme me burrat përkrah, të unshëm me shit mallin, dikund të mshehun aty prej përndjekjes dhe, në fund të ditës me mujtë me ble një a dy bukë gruni 40 lekshe, e dëshirueshme prej fëmijve të katundarit që e prodhonte grunin! Por në dhjetvjetshin e fundit të shekullit të XX, tolloni e radhat e pafundme për me mujt me ble gjithçka të nevojës vetëm sa me u mbajtë gjallë e kishin zhvleftësue e zbehë te s'ban. Çdo lavdi e dikurshme, tash kishte rã me krye poshtë e ishte kthye në gjendjen e saj komike... ***Si fëmijë na bahej mendja kùbel [njlloj peshku i lumit Buna] tue kalue prej një dyqani në një tjetër tue përsëritë emnin e kryefamiljarit para shitëses që shenjonte***

1 Sëmurë

Shënime rreth librit “Pa pikë pa presje”

MBAMENDJET E ARDIAN NDRECËS SI DËSHMI E NJË KOHE QYTETËSE TË LINGATUEM¹

nga Frano Kulli

në një rregjister. Nji ditë mbasdite nana, që punonte si rrobaqepse në shtëpi, më nisi me ble 10 lekë susta e un iu drejtova shitëses: Gjon Ndreca 10 lekë susta...

Edhe pa ndonji qëmtim të vemendshëm fort, po vihet re dukshëm se shkrimtaria e mbamendjes, ka kohë që ka bërë vend në dëshirën e leximit; kur shpërfaqet si një zhanderr i tillë, por edhe kur ndërthuret e i “kacavjerret” letërsisë (*fiction-t*). E sa ma shumë i largohemi së shkuemes aq ma e ngutëshme ndjehet kjo nevojë. Njisoj si me vënen, që sa ma e vjetër aq ma e kërkueme bahet. Por dihet se koha nuk ka fillim as fund; kufij e caqe në kohë ka jeta e personit në të. Janë personat rrëfimtari ata që e nderlidhin kohën prej një segmenti në një tjetër, prej një brezi të kaluëm te brezi që është e në brezin që vjen. Mbamendjet e shkrueme janë aq shumë jetëgjata ose aq pak jetëgjata sa ç’është në vedvedi mjeshtria e autorit që i shkruan; sa ç’është qëmtimi në to për me zgjedh e me i rrëfye ata që janë ma pikantet, ma të detajuemet prej tyne. Por që ndërkaq munden me u ba njëherësh edhe private për secilin lexues, i cili në të vertetë nuk i ka jetue ai vetë, por nga çasti i leximit tek ai shënohen si ndodhi e përjetime të vetë atij, njehsohen me të tijat. Aq fort, sa me i pasë shkruar ai vetë. Përndryshe, nëse kjo nuk ka ndodhë, atëherë kujtimet e lexueme, ndalen aty e dahan në një anë si rraqe të vjetra, që s’i lypen kuj gjatë.

Ardian Ndreca, i vetëdijshëm për këtë na e thotë qysh në dy fjalët e para për lexuesin se: **“nji libër kësodore nuk është një produkt i kërpitun.** [punë e bame mirë] **pse nuk ka gjatë ma të papërkryeme se kujtimet**”. Por, në të vërtetë kujtimet e tija të mbledhuna me një përkujdesje të përimtë tue ia nenshtruar edhe një pezullimit a pushimit njizetvjeçar në laboratorin e vet krijues, por edhe të lidhuna mirë me konsevantin e nevojshëm premtajnë me patjetër jetëgjatësi...

“Mund të kem qenë rrotull shtatë vjeç e me shkue në Shirokë më dukej si me shkue në një botë përrallash”. (Mua, si njeni prej lexuesve të radhës më vjen si i bashkëshoquem një kujtim i fëminisë sime i kund nja një dekadë të mahershme pyetja e bame me vetvedin: E ku lahen ata që s’kanë Drí ?!) Atje mandej, nder përshtypjet ma të para veçon të folmen e dallueshme të shirokasve me **“do zanore të hapuna**”. Që e mëson së parit prej nandajes. Kurse vonë, mjaft ma vonë në kohë të pjekunisë, atëherë kur interesi i rritun edhe për dijet në lamin e fonetikës e ban me i njoftë në mënyrë ma të thellueme, dallimet në të folmen e bashkëqytetarëve të vet të anës lindore me ato të anës perëndimore.

Në anën lindore të Shkodrës ku kanë jetue e jetojnë, kryesisht familjet katolike

e në anën perëndimore deri në Livade në breg të liqenit përgjithësisht ato myslimane. Andej e këndej janë banesat, veprat urbane. Bashkë me shumë tjeter, një pikë shumë e shenjueme e asaj çka ndan janë Vorret e Rrmajit. Themelue, siç është e ditun nga gjysa e parë e shekullit XVIII...Shí atëherë kur edhe në Europë varrezat katolike spostoheshin për arsye humane prej oborreve e rrethinave të Kishave e projektoheshin e ndertoheshin Varrezat publike.

Autorit i kishte ndodhë përgjatë fëminisë, të gjindej ndërmjet të dyjave, me gjysen e kohës te nandaja te Arra e Madhe në lindje e gjysen tjetër në shtëpinë e prindve në anën perëndimore. Ngjante diçka si kontrapunt, e duhej me kaluar ende do kohë me mujt me e kuptuar se kjo ndërthurje bante pjesë në krijimin e njeriut të ri, monokron pa dallesat, sidomos të atyne elementeve që lidheshin me përkatësi fetare. Qysh në klasën e parë pashë se “kishte edhe fjalë të tjera që un i shqiptoja ndryshe prej shokëve të shkollës. Un thoj **giu** ndërsa ata thonin **gu**, unë **giuhca** ata **guhca**, **kjoftë** për **qoftë**, **ndoshta** për **belqida**, apo ndonji fjalë tjetër, që po të më ndiente nana në shpi vrante vetullat...Edhe emnat e luleve



shqiptoheshin ndryshe kilometër për kilometër, tue mbetë po aq erëkandëshme e të hijshme. **Dhe e gjithë kjo lojë**-nënvizon autori-**kërkonte një impenjim të vazhdueshëm për me u idendifikue nga pikpamja gjuhësore me nenin prej grupeve, gjatë lypte mund dhe vemendje, mbasi edhe luhajtja ma e vogël vërehej menjëherë dhe po të rrëshqisje në rregjistrat e gabuem rrezikoje me u duk qesharak ose edhe ma keq...** Ç’prej aty zen e forcohet ndoshta ekzigjenca e autorit, që ma vonë përgjatë gjithë shkrimtarisë së vet të derikëtushme të përdorjë me mjeshtri të dallueshme variantin gegë të “Gropës së Shkodrës” që është edhe maja ma e epërme e naltimit të këtij varianti.

Mbamendjet ma të fundit që përkujtojnë me rropullinë e ndrrimit të sistemeve, djaloshtin, që shkollen se kishte qejf po ishte nxanës i mirë e gjejnë në gjimnazin e ri të qytetit me emnin “Oso Kuka”, krejt i papërshtatshëm simbas tij...Veçse u gjend me fat që mësuesja e letërsisë ishte e mirë. Një njohje e herëshme e saj me Lasgushin e me një librin e tij të pabotuem kishte qenë shkaku që të vinte aty për takime letrare Ismail Kadareja. Emni i Osos, trimit të përmendun edhe në “Lahutë...” mund të vihej kudo tjetër po në shkollë s’kishte perse. Ashtu siç nuk mujt me iu përshatë kurrë pranimit të morisë kryesuese të emërtimit të ri të rrugëve të Shkodrës veç me emna të luftëtarësh. Dhe të vendosjes në qytet veç të monumenteve të luftës së fundit, kryesisht. Por edhe të dikatorit simbol i përbotshëm urrejtjeje, Stalinit. Me rrëzimin e tij, në mënyrë të tërthortë gjindet i përziem përmes djelmnisë kryengritëse shkodrane, ku protagonistë të të cilit ishin edhe Kola që e kishim kushri dhe shoku i tij Rini [Monajka]. Edhe me Dom Simon Jubanin, protagonistin e Meshës së parë në 4 nandorin e nandëshjetës, kështu në rrethana të tërthora qe njoftë. I ishte dashtë me i shkue në shtëpinë ku jetonte, me një porosi prej Tiranet për të...Nji mbështetje e përkrahje prej diplomatëve perëndimorë, për atë që prifti kurajoz e i martirizuem po bante. Mandej, të dielen në Meshën që prej atij çasti u bërë famshme dhe...ikja.

Këtu mbamendjet e Ardian Ndreca “mpiksen”. Me pengun paplotënisë për të, por mbasi na kanë lanë dëshminë e çmueshme të një cope të lingatueme të jetës sonë qytetse.

ARDIAN NDRECA

PA PIKË PA PRESJE

Onufri



“Sëmundja e ëndrrave – Trilogji për vendlindjen” nga Mehmet Kraja

“SËMUNDJA E ËNDRRAVE” – HAKMARRJA E MITIT

nga Ballsor Hoxha

Në parathënien e librit të tij “Sëmundja e ëndrrave”, autori Mehmet Kraja shkruan ndër të tjera

“... rrëfeva për vendlindjen... në fillim duke u nisur mbi rrëfimet mitike dhe legjendat, dhe gradualisht, duke e përafëruar rrëfimin në kohë, arrita te grotesku, një ecje disi e natyrshme nga koha mitike tek ajo historike ... duke parë... se si miti transformohet në histori, ndërsa historia, ... disi merr atributet e të pandodhurës së mundshme...”

Ai vendos një paratekst të leximit të trilogjisë si “vështrim kritik” i të mundshmes së pandodhur, si anë tjetër e realitetit dhe si shpërfaqje e të përditshmes dhe të vetë vendlindjes.

Si përafrim i legjendës/mitikes së magjisë së vendlindjes me absurdin e groteskut të ndodhur dhe të bashkëkohësisë.

Trilogjia e Mehmet Kraës “Sëmundja e ëndrrave” mund të shihet edhe si një kalim (lexo: kapërcim) i njerëzimit nëpër historinë e perceptimit dhe shpjegimit të botës, apo për t’iu përmbajtur kësaj trilogjie – kalim i vendlindjes së autorit nëpër tri fazat e njerëzimit, që mund të shihet në tri perspektiva:

a) Perspektiva psikike e njeriut

Nga njerëzorja dhe fisnikja e pavetëdijshme (vetëdije të pakornizë, shih më poshtë në tekst), nga “problemi me paranë e dhuruar” e që është “mosdija se ç’të bësh me to”, deri në zgjidhje të po kësaj, e që është në “ndërtim të një ‘uble’ për të tjerët”; më tutje në kalimin e njerëzimit në vetëdijesim, e që nuk jepet si tjetër përpos si dorëzim dhe konfuzion ndaj absurdit të pafundësisë së “mbretërive” me “topat” e tyre, dhe me këtë shpikjes së – kalkulimit - të jetës, apo thënë më saktë kalkulimit të “ikjes në pallatin e vetë Pashës së Luftës”; e deri, tutje, tek sëmundja e piskës së njeriut, në këtë, kalimi i njeriut tek sëmundja e ëndrrave, sëmundja e psikës dhe sëmundja e njeriut, kalimit të tij në depresion të jermët.

b) Perspektiva e kalimit të shprehjes së njeriut ndaj perceptimit të tij

Në të vërtetë “Sëmundja e ëndrrave” është fiksjon që përmban tri novela mbi “vendlindjen”, të cilat e japin atë nga jeta në legjendë – “Ubla e Princeshës”; pastaj novela “Katundi midis dy mbretërive” mbetja e njeriut në ndërmjetësinë e legjendës/mitikes dhe reales apo asaj që autori në paratekst e quan “koha historike”; dhe novela e fundit “Sëmundja e ëndrrave” kur njeriu tanimë e lë prapa legjendën, e kjo duke mbetur në hije të njeriut, dhe njeriu duke pas kaluar vetë në “legjendar” përmes shpikjeve të tij si: ‘pushkatim’ dhe ‘shtab’, ‘gjq’, ‘pushtet’; thënë në gjuhën e Krajës kalimin në një “Botë pa mbretër”, në “botën bashkëkohore”.

c) Perspektiva e kalimit të njeriut nga naivja kolektive në kolektive të vetëdijshme

Ky është kalimi i njeriut nga naivja e tij, që jeton diku mes legjendës/mitikes/të mbinatyrshtes dhe realitetit; tutje në shkeljen mbi naiven dhe në çarjen e të natyrshmes dhe në këtë kurthim të tij ndërmjet legjendës dhe vetë topit të mbretit që shemb çdo gjë përpos pallatit të vet, pra kalimit në politikën e forcës së njeriut, politikë kolektive/të mbretërive dhe të forcave ushtarake, si dhe të kalimit të njeriut në besimin në fuqinë e ushtrisë dhe të mbretit, e që është kalim nga besimi në të mbinatyrshten në të besuar në realen. Dhe prej këtu, në novelën “Sëmundja e ëndrrave” kalimi në modernitet/bashkëkohësi ku kolektivi është mjet, që zgjatë bisedën (lexo: gjyqin) “dhjetë vjet”

“... ai i shtabit u nevrikos, filloi të shante nën zë... sa që një ditë dezertori pikasi me dhembje se ai i shtabit, ose ky i shtabit, përnjëherësh ishte mplakur dhe ishte

thinjur, sikur kjo bisedë të kishte zgjatur nja dhjetë vjet e më shumë... prandaj. Kur ai një ditë i tha dezertorit, a merremi vesh... u ngut të pohonte me kokë, megjithëqë as vet nuk e dinte se për çfarë mund të merreshin vesh.” (Kraja, “Sëmundja e ëndrrave”, p. 286.)

Autori Kraja në paratekst/parathënien e trilogjisë thotë ndër të tjera edhe se

“vendi ku kisha kaluar fëmijërinë dhe rininë e hershme kishte një histori dhe një memorie kolektive të jashtëzakonshme, e cila vinte nga thellësitë e kohës, si kompensim dhe kundërpeshë e kësaj bote që nuk i donte, por edhe si narracion i afërt me mënyrën e rrëfimit legjendar...”

Parateksti, në këtë rast kjo parathënie, është një ndërthurje e realitetit të librit me vetë përmbajtjen e tij, gjë që kalon në një marrëdhënie dhe përhapje të mëtutjeshme të vetë librit. Në të vërtetë – parateksti – e parashënjon tekstin vijues dhe e krijon shënjimin e librit si një varg.

Në këtë trilogji “Sëmundja e ëndrrave” nga Mehmet Kraja, krijon shenjën e vendlindjes si memorie kolektive e cila kompenson dhe i bën kundërpeshë një bote që “nuk e don”, dhe nën anën tjetër konceptin/shënjimin përmes trilogjisë, gjë që vetvetiu të thellon në gjuhën e këtij libri, si theks dhe si determinantë e këtij shënjimi.

Duke pas thënë këtë, “Sëmundja e ëndrrave” e Mehmet Krajës, është vepër që në boshtin e saj shpërfaq determinantën e gjuhës së saj, e cila ndërthurë të mbinatyrshten dhe të monotoninë e jetës naive dhe të përditshme në një fshat ‘Zotit prapa shpine’, dhe në këtë ndërton kalimin e psikës së njeriut nëpër kohë, në fjalë që ndërthuren në pashallarë e mbretër e topa e pallate, dhe më tutje në atë që u cek më lartë në zhdukje të fjalës mbretër/mbret, dhe ndërhyrje të një fjalori të ri si ‘gjqyq’, ‘shtabi’, gjykimi/dialogu, pushka etj.

Prandaj gjuha, apo thënë më saktë shpjegimi dhe perceptimi, duke filluar nga novela e parë janë vetë paranoja, paranoikja, si gjysmë shpjegim dhe gjysmë njohje dhe gjysmë imagjinatë, njëloj pavetëdije

vetëmbrojtëse, qoftë nga e mbinatyrshtja dhe qoftë nga fatkeqësia e pashpjegim, dhe qoftë edhe nga fatkeqësia natyrore në tërë vegjëlinë e njeriut në naiven e tij mitike. Kjo paranojë/njohje është sikur e pa vetëdije, pa një kornizë dhe gjërat që dalin jashtë saj, si personazhi Dardhojmeli dhe tërë ushtria bashkë me Prijësin e saj, ose tjetërsohen ose humbin në tërësi, duke mundur të kthehen në fshat vetëm si legjenda dhe legjendar. Qoftë edhe gjërat/njerëzit që vijnë në fshat (në universin letrar të kësaj trilogjie) janë njerëz që më shumë takojnë në – botën tjetër – se sa në realitetin e kësaj plazme (sikur që është fenomeni i kalimit të Princeshës me katër përcjellësit e saj në këtë fshat – Qafa e Ljares). Kjo pavetëdijësi, mungesë kornize, apo vetëdije e pakornizuar është një ‘pezullim’ i njeriut në këtë botë sikur gjuhë e cila është në lindje e sipër dhe tërë atë që e percepton dhe e sheh, si Princesha, njerëzit e zi (vetë përcjellësit e princeshës), Titulli Kont i dhuruar personazhit Mark Junkut, apo edhe vetë paraja/thesarët e dhuruara dhe pergamena, të gjitha këto shenja sikur ndërhyjnë në këtë pezullim dhe krijojnë një gravitet të njeriut në tokë dhe në ndarje nga natyra, duke – shpikur – edhe qëllimin e parësë me ndërtimin e një “uble”.

Gjuha në novelën e dytë, gjuha e shënjuar nga Mbreti dhe Topi i Mbretit dhe Ushtria e tij, e çon këtë njeri, këtë kolektiv në një banim/zhvendosje në urë, që shndërrohet në simbolikë të kalimit të njeriut nga legjenda dhe mitikja në reale, të ndarë nga bota.

Në të vërtetë këtu njeriu ende nuk e ka kaluar kufirin me vdekjen dhe ai ende flet me tjetrin dhe me veten në vdekjen e tij, sikur që janë personazhet e Malush Canit dhe Alush Ceni: pastaj personazhet e Bajram Sali Kurti dhe Xhemal Hasan Lani që edhe pse të vdekur vazhdojnë të paramendojnë kthimin dhe luftën me vetë pashën dhe padishahun e mbretërisë.

Në Novelën e tretë tanimë njeriu është një somnambul i cili në depresionin e tij prej të gjitha luftërave që kurrë as nuk kanë fund dhe as zgjidhje. Në të vërtetë, ky somnambulizëm është vetë rikthimi i mitikes dhe të mbinatyrshtes si jermi, si depresion dhe si gjuhë e cila është transformuar si kolektive e mekanizuar në mjet. Është vetë rikthimi i mitit. Vetë rikthimi i çarjes së botës vetëm për njeriun, duke e vënë atë në lojë, apo në bartës të një mitikeje të re, e këtu miti si magjia e vendlindjes (siç u cek në fillim të tekstit).

Në novelën e tretë, personazhi Halil Skjeja, i cili si ushtar i mbretërisë së Malit të Zi ka mbijetuar edhe komunizmin, mbetet i vetmi njeri i lirë, por vetëm pasi që ka kuptuar siç thuhet në këtë paragraf:

“... Çka u ba kështu me këtë botë, që u prish kaq fort? Çdo gja ishte përzier dhe ishte ba lamsh i madh! Nuk kishte ma as qiell ku të zinin vend retë dhe as tokë ku të derdheshin rrëketë, as hënë nuk kishte as diell që të lindte e të perëndonte, as dita nuk ishte ditë e as nata nuk ishte natë! Mbretërit i kishin lënë mbretëritë e tyre dhe kishin ikur diku larg, as xhandarë dhe xhandarmëri nuk kishte më, as kufi që të ruhej e as mbret që të mos shahej. Pthu. Botë e keqe!...”

Ndoshta ajo që i lidh më së miri këto kapërcime të perceptimit dhe të shpjegimit të ‘vendlindjes’ së autorit, vetë njeriut në prapavijë të saj, janë disa pyetje që do të mund të parashtrohen këtu, si vetë shpjegimi dhe po ashtu perceptimi i botës së këtij njeriu:

a. Ç’ është kont në një botë legjende ku tërë universi fillon dhe përfundon në fshatin tënd?

b. Ç’ është mbret, mbretëri, kur ato janë të panumërta dhe asnjëra nuk e ka as interesimin dhe as përkujdesjen ndaj vetë mbretërisë së saj?

c. Ç’ është gjyq, kur ai nuk arrin të shpjegoj mos-vdekjen dhe mungesën e varrit të njeriut të parë që e ka gjykuar dhe e ka ndëshkuar nën gjyqin e tij?

Në të vërtetë këto janë pyetje të cilat mund të merren si hapë tutje i njeriut, tutje në botën e re, një botë të re, duke u mundur në ankth që të ikë nga ajo e kaluara. Por ky hap, i progresit dhe vetëdijesimit, në gjyqe dhe biseda “dhjetëvjeçare” është në të vërtetë vetë kthimi i njeriut në ëndrrën e tij, në ëndrrën e tij sikur të personazhit të “toger Lanit” i cili në vetëvrastjen e tij në dëshpërim për mungesë të një mbreti (ndër të tjera) vetëvritet, derisa tërë ajo që ai sheh dhe kishte mundur të shoh ishte “një qiell i kaltër”.





SI U BOTUA LIBRI IM I PARË

nga Dimitër Shuteriqi

Ishte viti 1935 kur botova librin “Kangët e rinisë së parë”. Vitin tjetër botova përmbledhjen time të dytë poetike, “Kangë?”. Që ky titull përcillej me një pikëpyetje nuk ishte çështje modestie, ishte pohimi se ende nuk jam i sigurt për një arritje të vërtetë. Kisha një kuptim të lartë për artin. Që botova ka qenë një guxim. Por si bëhet pa botuar?

Si gjithë poetët që sapo nisin të shkruajnë, edhe mua nuk më durohej t'i shoh sa më shpejt vjershat e mia në një libër, le të ishte ky libër një broshurë e vogël fare. Vjershat që kisha shkruar ishin ende pak, por u gjend dikush që sapo lexoi diçka prej krijimeve të mia u entuzias e më tha: “Si të mos i botosh? Doemos duhen botuar dhe sa më parë, që sivjet, me këtë shterpësi letrare që kemi.” Ishte koha kur flitej për “shterpësi letrare”. Unë, sipas tij, do të provoja se letërsia jonë nuk na qenka aq “shterpësi”, të paktën në poezi. Këto fjalë të shokut më bënë të skuqem nga turpi. Numërova paratë që kisha dhe më dolën pak më shumë se tre napolona. Mora guxim e vajta drejt te Dhori Koti, një nga shtypshkronjësit e librashitësit më të njohur të asaj kohe. Librat shtypshkronja e Dhorit i botonte si mos më keq, aq sa Tasi Pika (vëllai i piktorit Vangush Mio) në librat që botonte tek ai vinte shënimin “Made in Albania”, d.m.th. bërë më shumë me këmbë se me dorë. Po ç'të bëja? Në Korçë ishte edhe shtypshkronja “Evangjeli”, por ajo s'mund të lëvdohej për më mirë, përkundrazi. Sidoqoftë, unë kisha besim se, po të mbikëqyrja vetë botimin e librit, diçka kishte për të dalë, huq që më mbeti për gjithë jetën, dhe jo vetëm për librat, por edhe për botimin e artikujve të mi.

Prita pak në dyqanin e Dhorit kur nga një derë, prej ku vinte zhurma e makinave, hyri një burrë i shkurtër me duar të llangosura, fizionomi e njohur për mua. Më vështroi pak e tha:

- Këtu nuk shes gjë, more djalë, siç sheh, dyqanin e kam matanë, - duke pandehur se doja të blija ndonjë libër a fletore.

- Kam ardhur për tjetër punë, - i thashë. Ai më hetoi e pastaj tha:

- Urdhëro e fol. Çfarë të ka sjellë?
- Dua të shtyp një libër, zoti Dhori.
- Kërkon të shtypësh një libër, more djalë? - m'u drejtua ai.
- Një libër, - përsërita unë me një zë edhe më të vendosur.

- Po përse e ke atë libër? - tha Dhori.
- Kam shkruar vjersha, - iu përgjigja unë.
- Vjersha? - tundi kokën ai dhe më pa mëshirueshëm e pak ironik. - Tërë bota vjersha shkruajnë, vjersha more bir. Sapo nisën shqipet të mësojnë e të këndojnë gjuhën e tyre, nisën të vjershërojnë. Se jemi edhe soj vjershëtorësh, de. Një të vritet, njëzet këngë i thurin. Para e humbur, more bir. Librat s'para shiten, kurse librat me vjersha... Ç'të të them? Mos shiko ato të Naimit. Lehtë shkruhen librat, por me zor shumë shtypen, se për të shitur, nuk shiten.

Dhori e pa që isha pak i ofenduar, e shpuri gjetkë fjalën:

- A s'më thua, more djalë i mbarë, cili të dërgoi tek unë?

- S'më dërgoi njeri, erdha vetë. Dua të shtyp një libër me vjersha dhe paratë i kam.

- Bukuri, bukuri, me këtë krizë ne punë duam, po a s'më thua: i kujt je ti këtu në Korçë, more bir? - tha Dhori.

- S'jam korçar, jam elbasanas, - i thashë.


- I shkruan vjershat gegërisht demek, po ta dish që hundake dhe të mprehta s'para kemi. Sa vjersha ke? - pyeti së fundi Dhori.

Unë nxora nga xhepi radhuan. Ai i hodhi një sy dhe së fundi më pyeti:

- Sa napolona ke, more bir?

- Tre, - i thashë. Futa dorën në xhep e i zgjata të tre napolonat, të cilat i numëroi dollar për dollar dhe më tha se libri im kushtonte tre napolona e gjysmë, por reston do t'ia jepja pas botimit.

Një mik librar mori përsipër ta vinte në shitje e ta shpërndante për hesap të tij librin “Kangët e rinisë së parë” dhe kështu u botua libri im i parë në vitin 1935.



POETIKA E RRËFIMIT TË FIGURSHËM

nga Sali Bashota

HYRJE

Tematika e zgjedhur dhe struktura rrëfimore, janë dy karakteristika të veçanta të prozës së Gëzim Aliut. Të gjitha shenjat e kërkimit shpiejnë të këta dy përbërës, të cilët e konstituojnë poetikën shkrimore të këtij autori. Prandaj, struktura narrative e veprave të tij në prozë, e parapëlqen një dije të sistemuar në planin e ideve, të tematikës, të procedimit, si dhe të komponenteve të tjera, të cilat ndërlidhen me fenomene letrare dhe estetike. Në këtë mënyrë, vlera dhe afirmimi i kësaj proze, pa dyshim, përcaktues kryesor mund ta kenë edhe invencionin dhe fantazinë, por edhe edhe prirje të tjera, për t'i shqiptuar tendencat rrëfimore përmes një elegancë stilistike, figurative dhe gjuhësore në domenin e prozës bashkëkohore shqipe, sidomos me romanet e tij: "Në Klubin e të shëmtuarve", "Katedralja pa kryq" dhe "Gosti në natën e parë të vjeshtës" dhe

Gëzim Aliu e ka krijuar një parabolë rrëfimore me ngjarjet që i trajton në romanet e tij. Ky dimension parabolik, pastaj edhe një qëndrim distancues në rrjedhën romanore, e fuqizon ironinë dhe paradoksin, por edhe përbërësit e tjerë në disa rrafshë, kryesisht përmes rrëfimit dhe përshkrimit mjaft preciz. Në fakt, temat që korrespondojnë me realitetin, i mundësojnë autorit, në radhë të parë, për të përcaktuar strategjinë e rrëfimit sipas një ndjeshmërie me konceptim të qartë dhe shumë domethënës.

Në lidhje me karakteristikat e rrëfimit në të tri romanet e Gëzim Aliut, del sheshit mjeshtëria e sajimit të situatave, të cilat e fuqizojnë përmasën e një ndjeshmërie poetike që i rri pranë e pranë përshkrimit dhe figurës, stilit dhe gjuhës, pozicionimit të rrëfimtari. Në rendin e fuqizimit të domethënies së ngjarjeve, autori e parapëlqen kontrastin midis rrëfimtari dhe personazhit, kur rrëfimi bëhet në veten e parë, siç ndodh në romanin "Në Klubin e të shëmtuarve", pastaj në romanin e dytë, kur kemi dy pozicione dhe perspektiva rrëfimore (*shkrimtari që rrëfen për kryepersonazhin e romanit, ndërsa në vijën e dytë narrative, është vetë piktori që shndërrohet në narrator...*, siç konstaton autori), ndërsa në romanin e tretë "Gostia në natën e parë të vjeshtës", rrëfimi bëhet në veten e tretë.

Në këto tri romane të Gëzim Aliut, strukturohen tri nivele të rrëfimit, duke sistemuar dhe funksionalizuar temat që ndërlidhen me jetën, dashurinë, artin, të mirën, të keqen, të panjohurën, ideologjinë, frikën, fatin, moralin, pabesinë, banalitetin, injorancën, trishtimin, zemërimin, vetminë, vrasjen, vdekjen etj. Prandaj, struktura rrëfimore zhvillohet në atë mënyrë, sa që intriga e fabulës, pastaj mbizotërimi i përshkrimit magjepsës dhe psikologjik i personazheve, botëndijimi dhe botëkuptimi i tyre, rikthimi në situatat e ndodhura si kujtesë, barten nga

procesi i ngjarjes në procesin e veprimit, midis përditshmërisë, ëndrrës dhe iluzionit. Gjithsesi, idetë, tematika, motivet, etj., konceptohen qartë në rrjedhën romanore dhe ndëtojnë një relacion kuptimor e simbolik midis rrëfimtari-personazhit dhe ngjarjeve. Kësomënyrë, fuqizohet edhe ambienti i figurshëm përmes ironisë, groteskut, alegorisë, paradoksit, etj., për të problematizuar dukuri dhe fenomene të realitetit ekzistues dhe të atyre që mbahen mend si përjetim i të ndodhurave në retrospektivë. Ky aspekt, ka të bëjë me rrëfimin paralel të ngjarjeve, duke ofruar vëmendjen për receptimin e tyre edhe te lexuesi.

FUNKSIONI RRËFIMOR I SHENJËS

Tregimi "Kokrra e zezë", i cili është shpërblyer në një konkurs letrar dhe i cili është botuar në librin e tij me tregime, është zanafilla e romanit "Në Klubin e të shëmtuarve". Forma e shkurtër e tregimit bëhet model i madh i romanit, aty ku motivohet ngjarja dhe shfaqet admirimi për të rrëfyer deri në fund të bukurën, edhe pse e shëmtuara portetizohet e zbërthehet në koleksionin e ëndrrave të rrëfimtari. Esenca qëndron në relacionin e ndërtuar përbrenda konturave të rrëfimit, aty ku procedeu zhvillohet në planin e ideve, të cilat synojnë dhe arrijnë bukurinë



S. Balishota

e pastër të imazhit. Konceptimi i situatave erotike, përbrenda tablove të përshkrimit, gjithsesi edhe në krijimin e efektit estetik përmes një rrëfimi të tillë të shkathët dhe të zbukuruar me fantazi, rezulton në krijimin e ndjenjës kryetipore për të thënë se rrëfimi në këtë roman mund të ketë ngjashmërinë e krahasimit të bukur e magjepsës, në radhë të parë, në domenin e përshkrimit, fjala vjen, me romanin "Inati" të Philip Roth.

Në romanin "Në Klubin e të shëmtuarve", kuptimi i dashurisë ndërtohet në variantet e rrëfimit qoftë si copëza kujtimesh, dromca përjetimesh apo si sfond psikologjik. Po aty, përcaktohet rendi gjuhësor, stilistik, sintaktik ku paraqitet hapësira letrare për meditim. Admirimi i flaktë i rrëfimtari për ta

zbërthyer enigmën dhe fatin e njeriut të traumatizuar nga të këqijat e kësaj bote, me imazhin e mbindërtuar nga situatat erotike në roman dekompozohet përmes përmasës së shpjegimit të dimensionit të dashurisë, të cilat janë: përvuajtënia, kënaqësia, mëkati, pasioni, shpëtimi. Romani "Në Klubin e të shëmtuarve", në mënyrë kronologjike ndërtohet skena simbolike ku rrëfihen ngjarjet, ku tipizohen personazhet, ku ndërthuren vizionet e rrëfimtari. Situata rrëfimore përkufizohet me gjendjen e përfytyruar dhe të shpërfytyruar: përcaktimi i ambientit, gjërat që ndodhin, soditja nga dritarja; pastaj pasqyra, ëndrra, telefoni, si dhe përcaktuesit e tjerë: ftesa për të shkuar në Klubin e të shëmtuarve, krahasimi apo paralelizmi midis ngjarjeve që ndodhin në roman dhe atyre që kanë ndodhur më parë në jetë, si çast i ruajtur në kujtesën e rrëfimtari. Romani i Gëzim Aliut e funksionizon tematikën e dashurisë, duke karakterizuar personazhe (Liria, Besa, Shpresa, Selvia, Luljeta, Shkëndia, Lavdia etj.), pastaj ngjarje, ndodhi, situata, skena, akte, përjetime, etj., vështruar nga rrëfimtari aktiv, i cili me halucionacionin e "Kokrrës së Zezë", i shtreson modelin e prozës psikologjike, vizionin specifik për karakteret e çuditshme. Alegoria e filozofisë së romanit nis që nga episodet e kohës së fëmijërisë, nga ambienti rural për t'u bartur në ambientin urban, pastaj mentaliteti, doket, zakonet, veset deri te shenjat



e ashpërsisë njerëzore, në njërën anë dhe deri te përmbushja e lumturisë së njeriut, në anën tjetër. Gëzim Aliu i ka parashikuar gjashtëmbëdhjetë kapituj të këtij romani, ku secili kapitull është një episod i shkëlqyeshëm i rrëfimit, prandaj shkreptima figurative e përshkrimit mbizotëron, pothuajse, në pjesën më të madhe të rrëfimit. Topika e romanit e përcakton kohën dhe hapësirën, pikërisht me gjendjen shpirtërore të rrëfimtari. Në Klubin e të shëmtuarve funksionon intriga e fabulës në raportin: *rrëfimtari-Luani specialisti i estetikës*, të cilët i thurin dhe i shthurin aktet e dramës së personazheve të tjera në ambiente të caktuara, aty ku shkallë-shkallë shtjellimi simbolik i imazheve krijon ambientin e figurshëm për rrëfim. Për më tepër, idealizimi dhe karakterizimi i situatave rrëfimore nënkuptohet përmes gjesteve dhe sjelljeve të personazheve, jo rrallë si harlisje e instinkteve të tyre për t'i motivuar skenat dashurore. Assesi, përshkrimi i tyre nuk ka të bëjë me rutinën, që si zakonisht është e pranishme në tipin e romaneve me dekor realist, por është theksim i fuqishëm i komponentes stilistike dhe figurative, që del pikërisht nga esenca e rrëfimit dhe përshkrimit.

NIVELET E SHQIPTIMIT TË NGJARJEVE

Romani i ka dy nivele të shqiptimit të ngjarjeve. Niveli i pare, ndërlidhet me rrëfimin e ngjarjeve në kohën e tashme dhe niveli i dytë, ndërlidhet me përkujtimin e ngjarjeve nga koha e shkuar, ndërkaq analiza e simbolikës së romanit, e cila projektohet përmes Kokrrës së Zezë, e krijon tezën mbizotëruese të rrëfimit që ndërlidhet me parandjenjën, e cila shpërfaqet në marrëdhënie të caktuar me shenjat që krijojnë gjithmonë efekt të ri psikologjik në zhvillimin kronologjik të fabulës.

Gëzim Aliu e funksionalizon rrëfimin përbrenda pyetjes së rrëfimtari: "në zemrën time rrotullohen vetëm dy gjëra-unë dhe Kokrra e Zezë". Romani "Në Kubin e të shëmtuarve", është roman i ndërtuar përmes episodesh, siç janë: shpërngulja në Shehër të Madh, detaji i varrosjes së gruas së dytë të xhaxhait, imazhi i shtëpisë së vjetër, rrëfimi për Bahtirin, rrëfimi për Selvijen, analogjia rrëfimore me filma të ndryshëm erotikë, pacientët që duhet të shërohen për të mos dalluar të shëmtuarën dhe për ta paraqitur atë si të bukur (përcaktimi i kuotës së shëmtisë) deri te klithma e rrëfimtari se e bukura nuk do të ekzistojë më. Të gjitha këto paraqiten me mjeshtëri në romanin e Gëzim Aliut.

Po kështu, romani "Në Klubin e të shëmtuarve", krijon një modalitet të ri në procesin e të rrëfyerit për të ndërtuar fushën semantike midis ngjarjes dhe kundërngjarjes. Ky fenomen është i pranishëm në situatat e krijimit të pesë pavijoneve të ndërtuara në laboratorin krijues të rrëfimtari: *pavijoni i pranimit, pavijoni i kontrollit, pavijoni i rrëfimit, pavijoni i pajtimit dhe pavijoni i pages*. Tipizimi i personazheve, krijimi i tablove, i situatave dhe ngjarjeve, sikur ngjan me skenat, aktet dhe dramën shpirtërore të personazheve, si te "Komedia Hyjnore" e Dantes.

Pra, bëhet fjalë për shërimin e Kokrrës së Zezë, një ndjeshmëri e shtresuar përmes rregullave të katarsisit, për t'i shenjuar pikat e afrimit dhe të largimit, midis asaj që është shpikur, tjetrës që është prani rrëfimore dhe asaj që mund të ndodhë, që është faktikisht filozofi e të përfytyruarit. Kësimënyre, mund të formësohej akti i rrëfimit dhe përftesa e përshkrimit:

"Në atë zbrazëti të kristaltë, vezulluese, gdhendej relievi i qytetit, i qytezës, i katundit, shihja edhe bllokun e shtatë ndërtesave të rrjepura, në njërën prej të cilave jetoja unë, në katin e tretë, nga dritarja e së cilës vështroja bërllokishtën dhe hollinën e tymit që shkonte përpjetë qiellit të mbushur me vranësira të zeza. Larg, shumë larg,

plasaritje të kaltra, të herëpashershme, gjëmonin shurdhshëm, pa i dëgjuar askush."

Autori sikur bën një hulumtim sistematik, për t'i evidentuar dhe karakterizuar fenomenet dhe dukuritë e realitetit jetësor, madje sikur të ishte fushë e psikanalizës, për të ndërtuar formula fatesh në kuptimin e jetës dhe të ekzistencës, madje për të dëshmuar sikur të ishte rrëfimi i vërtetë dhe jo një trillim i bukur poetik e magjiplotë.

Synimi i ngjarjeve shpjegohet përmes tipizimit të personazheve në raport me fabulën, intrigën dhe rrëfimin. Episodet përshkruhen në mënyrë simbolike përmes përcaktimit të shenjave emërtuese për tipizimin e personazheve: të shëmtuar, gjysmë të shëmtuar apo në shëmtim e sipër. Metanarrativiteti në këtë roman ndërlidhet me zërin e narratorit, i cili e fton personazhin (Luanin) që të jetë bartës dhe realizues i veprimeve, pastaj rrjedha e rrëfimit funksionalizohet në disa plane të veprimit dhe të rrëfimit: njeriu me gungë maje hundës së madhe, gruaja me gjinj të mëdhenj e ballë të vogël; epiteti, gjesti, veprimi, hapja e dosjeve, postet, karrierizmi, defektet e shoqërisë, lakmia, prostitucioni; zhdukja e së bukurës dhe zëvendësimi i saj me të shëmtuarën, pastaj legjenda për Kokrrën e Zezë, si dhe ndjenja e katarsisit, e shqiptuar përmes rrëfimtari për të ndodhurat në klubin e të shëmtuarve. Në kapitullin e nëntë të romanit shqiptohet më fuqishëm ironia ndërtekstuale. Pavijoni i rikthehet rrëfimtari në postmoderne, pikërisht me ngjarjet e ndodhura në ku frymon groteskja, ndodhitë e Sherifit, Azizit, Sheremetit; pastaj muret e bardha, lapsi, fletorja, dhoma e rrëfimit. Secili në mënyrën e vet në shkallën e vet të ideografisë, për temat e përshkruara. Gëzim Aliu e funksionalizon strategjinë e rrëfimit, duke e kapërcyer sfondin moralizues për të arritur tek domethënia alegorike, nga kureshtja e rrëfimtari deri te kënaqësia e personazhit. Gjithashtu, edhe fjalët: *Kotësi, Gënjeshtër, Pakuptim*, paraqiten në një kontekst të ri semantik, duke u bërë


simbole përmes funksionit të tyre, ndërkaq dalja nga klubi i të shëmtuarve është realja e rikthyer në fantastikë. Aty zbërthehet kodi i rrëfimit përmes paragjykit se çmenduria ishte udha më e lehtë për të mbërritur deri te shërimi, kështu që klithja e rrëfimtari: "Shërimi varet nga vullneti yt nënshtrues ta pranosh të shëmtuarën e ta urresh të bukurën", është deshifrim i koncepteve estetike përbrenda dramaticitetit të ngjarjeve.

Autori flet për një klub, në të cilin mbizotëron kategoria e personazheve të shëmtuara. Lumturia dhe virtyti i tyre ka të bëjë me shëmtinë, në një ambient ku shpiket misterit edhe për fytyrat e karakterizuara që shprehin gëzim, sikur edhe për ato që shprehin pikëllim. Në fakt, zvogëlimi apo zhdukja e shëmtisë sikur nënkuptohet nga parandjenja e rrëfimtari për të hyrë në botën e llahtarshme të veprimit të skenave të përfytyruara. Mbase këtu kemi të bëjmë me parandjenjën e ikshme, pikërisht për atë se çka do të ndodhë në situatën tjetër të rrëfimit, mbase shkatërrimi i Klubit të shëmtuarve është fshirja e kujtesës.

Duke e përkufizuar natyrën e zhvillimit të rrëfimit, përshkrimet e brendshme dhe të jashtme, gjithsesi, domethënia e ngjarjeve në romanin "Në Klubin e të shëmtuarve", ndërlidhet me figurat e tablove të krijuara sipas statusit dhe pikëshikimit të rrëfimtari për gjendjen psikologjike të personazheve, aty ku zbërthehet e ndodhura, mendësia provinciale, njohja, vetënjohja, kujtimi, ëndrra, halucinacioni, bota e kënaqësive fizike e shpirtërore, problemi dashuror e seksual, aventurizmi, vokabulari vulgar, etj.

Romani "Në Klubin e të shëmtuarve", është roman i ngjarjeve dhe njëkohësisht edhe roman i personazhit. Nëse personazhi, është *shpirti i prozës*, sipas Forsterit, në romanin e Gëzim Aliut, shpirti i prozës është rrëfimi. Gjithsesi, një rrëfim i mrekullueshëm me vlerë letrare dhe estetike në të gjitha nivelet.





ROMANI “ULKU DHE UILLI”, I VATH KORESHIT

(Ose, anatomia e shpirttrave të periferisë)

nga Petrit Palushi

Romani “Ulku dhe Uilli”, fillimisht është botuar në Tiranë në vitin 1996 nga Onufri dhe në vitin pasardhës fitoi çmimin e Fondacionit Velija. Roman që mori vlerësim të meritueshëm. Kjo, për shkak të cilësisë së lartë të tekstit: dramatika e tij dhe veshja e kësaj dramatike me pejza të vetvetishme të lirizmit, duke na dhënë kësaj në formën më sugjeshive lëngatën e shpirttrave njerëzore.

Veptra letrare e V. Kreshit është e shprehje e ndjeshmërisë së ekzistencës së individit (personazhit), është mishërim i trandjes njerëzore deri në skajet më të epërme, ku individ është në përballje të paprajshme me mungesën e elementëve më të dukshëm të ekzistencës. Individ kësaj gjen strehë vetëm tek vetvetja dhe jo tjetërkund. Në këtë mjedis përpëlitjesh, hamendjesh, stërvuajtjesh, thyerjesh dhe ringritjesh morale, individ (personazh) nuk jepet si personazh skematik, si personazh kukull, por me një natyrshmëri të spikatur dhe formësohet në specifikën e tij çka e bën të dallueshëm si individ, që ka frymën dhe vetjakësinë e tij, që sillet brenda një rrethi të mbyllur përpëlitjesh dhe dramash ekzistenciale. Formësimi i individit dhe, në të shumtën e rasteve, vetëm si i tillë, i ka dhënë letërsisë së Kreshit kuptueshmërinë e prezantimit të fatit të individit në rrjedhën e tij të natyrshme. Një fat specifik i secilit personazh, i pangjashëm nga njëri-tjetri, në opusin e krijimtarisë rrëfimore i ka dhënë kësaj letërsie dimensionin e një letërsie të realizimit të fateve të trazuar.

Situatat ekzistenciale natyralizohen, bëhen të besueshme, të përnjëmendta dhe kësaj merr frymë kompleksi narrativ në tërësi, dmth., funksionon natyrshëm si një mëvetësi narrative.

Anatomia e shpirttrave të periferisë

Në një intervistë të vitit 1997, shkrimtari është shprehur se “...këtë libër e kam shkruar për të treguar se ç’ndodh me shpirtat njerëzorë kur janë të detyruar të jetojnë në skajet e qytetërimeve. Skajet janë si anët e livadheve, ku bari është më i shkurtër dhe më i pazhvilluar se ai që rritet në mes”. Në pamje të parë, autori ka bërë një paraqitje të fabulës së rrëfimit të tij, por kjo është vetëm pamja e jashtme e kundrit të veprës. Nga brendësia e tekstit është njëri prej personazheve që përpikët të shpjegojë labirintin e një

jetë të tillë: “Jemi në skaj, - ia mori këtë fjalë nga mendja Frederiku - dhe skajet janë të shkëlme dhe barin s’e kanë fort të rritë”. Kjo do të thotë se fabula ka jetuar më së pari intensivisht në trurin e shkrimtarit dhe më pas është lëngëzuar dhe ka marrë formë si tekst artistik, çka e bën të besueshëm faktin se në raste të tilla shkrimtari kthehet lehtësisht në interpret të ngjarjeve, i gdhend dhe i lëmon me syrin e mjeshtrit. Ngjarje të tilla dalin para syve të lexuesit rrjedhshëm, herë si pamjet e një filmi, herë si peizazhe të mbuluara me një gri të errët, herë edhe si copëza imazhesh që zëvendësojnë njëri-tjetrin sipas një rregullsie të caktuar. Për sa u shtrua më sipër, kjo ka të bëjë me të jetuarit intensivisht me veprën në çastin e krijimit, ndërsa sendërtimi i tekstit, s’është gjë tjetër veçse ana formale apo teknike që kryen shkrimtari.

Në krahasim me novelat “Dasma e Sakos” dhe “Haxhiu i Frakullës”, ku lexuesi duhet të përfundojë leximin për të mësuar se ç’ndodh në të vërtetë, në romanin “Ulku dhe Uilli”, është operuar krejt ndryshe. Është një lloj teknike si e Anton Pashkut tek romani “Oh” apo në disa prej tregimeve të tij. Në kesi rastesh, shkrimtarët prezantojnë një ngjarje pikante të veprës, ose fundin e veprës, që në fillim të saj. Në romanin “Ulku dhe Uilli”, që në fillim paralajmërohet se ngjarjet e veprës do të futeshin nëpër labirinte: “Ka ndodhë një ngatrrësë, një grua e ka ngatrrue munshinjur Agushtinin dhe e ka marrë për të vëllanë e tij, munshinjur Bdekun”.

Prezantimi i dramatikës në fillim s’e ftoh lexuesin, përkundrazi e grish atë për të ndjekur me intensitet rrjedhën e ngjarjeve. Hapja e perdes do të paraqesë një grumbull pamjesh që jetësohen nën një qiell të ngrysur. Në rast se do të flitnim për trazime shpirtërore të personazheve apo mungesë të theksuar të drejtpeshimit të tyre, kjo ka të bëjë me çorganizim (luhatje) të veprimtarisë së tyre, me një trazim të kohës në të cilën veprojnë, me fjalë të tjera, me prishjen e sistemit normal të jetesës së tyre. Në këtë rreth vështrimi kryhet edhe anatomia e shpirttrave të periferisë, ndërsa lexuesi vazhdon të kundrojë pamje realisht estetike.


Ikja prej demonëve të së keqes

Romani “Ulku dhe Uilli”, është një vepër mbi vetërrënimin dhe ringritjen morale, një vepër mbi

ankthin ekzistencial; ky roman është një requiem i munguar për vlera të humbura, por njëkohësisht edhe për rigjallërimin e tyre; është një roman për trandjen shpirtërore të personazheve, mbi krizën shpirtërore dhe ripërtëritjen morale.

Përshtypja më e parë që krijohet është se kemi të bëjmë me një jetë të turbullt, të shkruar dhe të ankthshme, të veshur me një pëlhurë absurdi, që sillet brenda një rrethi vicioz. Ndërkohë, segmente të absurdit janë vizatuar përmes dridhjeve më të holla të penës së shkrimtarit, duke na dhënë peizazhe të lëvizshme të një jete të ngrirë. Secili prej personazheve është kryepersonazh më vete me gjurmë të veçanta dhe të dallueshme brenda mjedisit dhe në rast se për një kohë të caktuar nuk shfaqet nëpër ngjarje të veçanta, ndihet fuqimisht prania e tij. Kësaj është i përfshirë në merimangën e jetës së vranët dhe turbulluese.

Kur shkrimtari në fillim të veprës informon lexuesin se “...Ka ndodhë një ngatrrësë...”, dhe prezanton vëllezërit, Bdekun dhe Agushtinin, që “ngjanin si dy pika uji me njeni tjetrin”, ka paralajmëruar, sidoqoftë, për fatin e ndryshëm të dy vëllezërve, të cilët do të rrjedhin secilin në hullinë e vet. S’është e vështirë të vërehet se kemi të bëjmë me një trupëzim të së mirës me të keqen, një ngjitje, pra e mira me të keqen pranë e pranë. Personazhet lëngojnë, lëngon i gjithë mjedisi mu për shkak të vlerave të vetërrënuara: demonët e së keqes kanë lëshuar rrënjë në shpirtin e personazheve dhe shkrimtari intuitivisht krijon një realitet tragjik të prekshëm, të gjallë, estetikisht të besueshëm, ku dhe fryma e personazheve është natyralizuar dhe mu këtu qëndrojnë vlerat më të qenësishme dhe të spikatura të romanit. Kur shkrimtari lëshon këmbanat e alarmit për largimin e demonëve të së keqes, në tekst shihet se kjo gjë bëhet krejt natyrshëm dhe nis të lëvizë drita edhe në mes të territ. Mund të përmendnim vetëm dy shembuj: Julias së vogël i vijnë sytë dhe aty kah fundi i romanit Zonja Hura dhe munshinjur Agushtini vërejnë se ikona nuk është djegur; gjithsesi lëviz drita e lartë e arsyes, e mbledhjes së vetvetes dhe zona e shkruar tani nis e merr frymë, merr frymë dalngadalë, por në fund të fundit, nis e merr frymë lirshëm. Është e natyrshme që vepra të këtij lloji si romani “Ulku dhe Uilli”, po të ekzistonin një dekadë më parë, do të anatemohehin prej kritikës socrealiste pikërisht për nxirje të realitetit, dmth. do të qortohej aty ku ishin vlerat më të mëdha të veprës. Në romanin “Ulku dhe Uilli”, Vath Kreshi ia ka arritur të krijojë artistikisht zonën ku vepron njeriu, e ka delegendarizuar realitetin, e ka demitizuar personazhin. Por shkrimtari me këto ndërthurje të situatave dhe fateve të personazheve, me këto ndriçime të labirinteve të kohës për të cilën bën fjalë, përpikët gjithashtu të ridimensionojë vlerat njerëzore, për mungesën e të cilave vegjetonte një situatë absurdi



si ajo që paraqitet në romanin në fjalë. Në hapësirë të ridimensionimit të vlerave, shkrimtari e ka parë të arsyeshme të ballafaqojë situata paratraumatike dhe pastraumatike dhe këtë e zgjidh në roman përmes ndjesës që kërkon njëri nga personazhet, gjë që njëkohësisht ka të bëjë edhe me rikthimin e besimit tek vetvetja: *“O, oh moj Zonja e Lumnueme, moj nëna jonë e shenjtë! Na i fal mëkatet dhe na i pastro shpirtërat!”*.

Dalngadalë prishet rrethi vicioz ku vegjetonte jeta e personazheve; një nga shenjat më të dukshme të saj është edhe mbyllja e romanit ku veprojnë personazhe të tillë si Zonja Hura dhe Agushtini që sjellin mesazhe të rëndësishme dhe plot dritë, në krahasim me fillimin e romanit ku veprojnë Bdeku dhe Agushtini, në situata krejt të tjera.

Përsosmëri e stilit

Mund të thuhet në prozën e Koreshit, si domos tek “Konomea” dhe “Ulku dhe Uilli” hetohet perfeksionimi i stilit që shpesh arrin deri në virtuozitet. Ndërsa, kur lexon edhe një fragment të vetëm të romanit “Buddha”, pa kurrfarë teprie do thënë se kemi të bëjmë me një mëvetësi stilistike apo dallueshmëri stilistike. Arti i tij i sugjestionit përmban në vetvete, veç të tjerave, edhe metaforifikimin e rrëfimit, lirizmin e plotë, latimin e fjalës, fjalisë dhe në këtë rast sintaksa e pastër që i jep lëmueshmëri fjalisë jo vetëm në formë, por dhe në kuptimshmërinë e saj.

Në pamje të parë, duket sikur mungon hapësira vepruese e personazheve ose këto personazhe kanë hapësirë shumë të ngushtë veprimi. Kjo ka të bëjë me konceptimin e përgjithshëm të veprës për një kohë të caktuar: profili i një jete të tërë njerëzore që dalngadalë del nga një tunel i errët; drita e atmosferës thyhet dhe në vend të saj nis dhe vepron drita e arsyes. Prandaj lexuesi mund t’i referohet një kohe të caktuar, një situatë të caktuar, aq më tepër që kjo vepër merret me zonën e shpirtrave të autoktonisë.

Kur kundrojmë më nga afër stilin e romanit, pa hyrë në të gjithë mekanizmat a pjesët e veçanta stilistike, do evidentuar stili telegrafik i rrëfimit; ngjarjet në roman rrjedhin me një shpejtësi marramendëse që të kujtojnë rendjen në nja garë të fuqishme vrapimi dhe ku spektatorët mbajnë më në mendje vetëm fituesit ndërsa humbësit i fshijnë me të parën herë nga kujtesa sikur të mos ishin fare pjesëmarrës të garës. Kjo është një dukuri e njohur në letërsi, por kur përdoret me sukses, rrafshi i veprimit të personazheve zgjerohet, lihen menjanë ngjarjet thuajse periferike dhe i mëshohet së tepërmi ngjarjeve më pikante që i japin frymë veprës. Për shembull, romani “Qyteti i fundit” i Petro Markos, apo dhe tregimi “Saku” i Ymer Shkrelit. Në romanin “Ulku dhe Uilli”, edhe kapitujt e shkurtë bëjnë pjesë në këtë lloj stili dhe kapërcehen vite dhe ngjarje të tëra, për të mbërritur aty ku e ka synimin artistik shkrimtari dhe çdo gjë të shkojë në përshtatje me idenë e tij. Në kapitullin e fundit ngjarjet rrjedhin aq shpejt, si të thuash telegrafisht, sikur përplasen njëra me tjetrën, sa që personazhet sikur mezi marrin frymë (është fjala për Zonjën Hura dhe munshinjur Agushtinin); dinamizmi i këtyre personazheve tashmë është në shkallën më të lartë.

Fragmentarizmi në strukturë të veprës

Më sipër prekëm kalimin e ngjarjeve pikante në mënyrën më të shpejtë dhe mënjanimin e atyre ngjarjeve të dyta e të treta që shpesh quhen edhe si periferike. Kjo mund t’i japë romanit pamjen me pjesë të fragmentarizuara. Do thënë se fragmentarizmi nuk e zbeh rrëfimin, s’e humb lidhjen organike ndërmjet pjesëve. Përkundrazi. Fragmentarizmi trupëzohet krejt natyrshëm në arkitekturën e përgjithshme të veprës: ngjarjet duke u paraqitur si të shpërndara, mund të japin jo vetëm çrregullsinë e një kohe të caktuar, por edhe si shenjë për të tërhequr lexuesin vetëm në ngjarjet më pikante, më të domosdoshme. Kjo gjë e dendëson rrëfimin dhe e mbush atmosferën me peizazhe që ndërrohen ngutshëm. Tek De Rada, tek “Këngët e Milosaos”, dihet për shembull se ç’rol luante fragmentarizmi në krijimin e përgjithshëm të atmosferës.



Ke veshur bluzën time?
Po se po ndihem më e lirë në të.
Të ka dal krahu dije.
Po, po e di.
T’i shpupurisha flokët, i ke shumë të mira.
Do ti që t’i rris më shumë?
Si ta ka qejfi.
Ja që s’dua, nuk më pëlqejnë flokët e gjatë, e kam fytyrën e vogël më mbulohet krejt pastaj.
Ha çfarë argumenti na vdiqe krejt.
Jo mor vetëm po tregoj si e shoh unë.
Kafe?
Po dua.
Engjëll po të shndritë fytyra.
Gjithë e kam kështu besoj.
Jo, jo gjithë, sot po.
Seç më deshi Zoti prandaj më bëri kështu.
Si kështu?
Ja të pranueshme pra, si engjëll, si thua ti.
.....
Pse je ulur në tokë?
Ka kohë që më pëlqen të ulëm kështu.
Do të ftohesh.
Mbase por nuk ndalem derisa të humb merakun.
Merre kafen dhe..
Dhe çfarë?
Do të shkoje nëse vjen dita që mos të të pëlqeja më?.
Natyrisht.
Pse po qeshë çfarë ka këtu për të qeshur.
Asgjë jo, vetëm thashë atë që mendoj, do të shkoja natyrisht sepse çfarë do të te duhesha ashtu. Do ikje ti?
Po sikur të të merrte malli fort, fort do të më thërrisje në telefon?
Pse po e devijon bisedën, do ikje ti?
Po edhe unë.
Më vjen mirë pra.
Ama po të më merrte malli fort, fort do të të thërrisja në telefon, do të të thërrisja. Dhe po të më vinte të kthehesha, do të kthehesha, do më pranoje ti?.
Varet, jeta mund të ketë marrë drejtim tjetër.
Përgjigje diplomatike. Do më pranoje ti?.
Po.
I marrë.
....
Më jep dorën, zgjohu prej aty sepse pastaj nuk mund të të shohë si vuan pasi je ftohur, je ftohur keq. Të tërhoqa më shumë se sa duhet më fal, po je bërë e rëndë duke qëndruar ulur.
Jam shëndoshur thua?
Vërtetë je e marrë do të vdes duke qeshur.
Më pëlqen të jem e marrë.
Nuk je jo edhe kur bëhesh sikur, nuk je.
Të ecim pak, nën mollë?
Ecim.
Më pëlqen shumë kur ju merr erë pemëve, e ke zakon?
Po më pëlqen shumë të bëjë këtë gjë. Kur isha fëmijë u merrja erë pemëve. Nana më shikonte me habi, pasi zakonisht nuk i haja po u merrja erë, po.
E çuditshme kjo s’më ka rënë të dëgjoj.
Po sepse unë jam e çuditshme, a s’më thua ti kështu.
Jo unë të shikoj se si rëndom nuk kërkon asgjë, si ka mundësi?
Çfarë të kërkoj, atë që s’ke mundësi ta besh?
Jo vetëm kjo, ha pak, flet pak, nuk ankohesh si ka mundësi?
...
Mos e kafsho mollën!
Pse po bërtet, mos më thuaj që sa herë një grua kafshon një mollë ndodh diçka e keqe. S’është e thënë.
Pse po mendon se nana jote është e zhgënjyer me ty?

Sepse gjithë ka menduar se mund të bëj më shumë, se kam kapacitete të bëj më shumë. Sa herë e kundërshtoj, të kam fëmijë më thotë kush të njeh më mirë se unë. Tregon s’e si e kishte të lehtë t’ mi mësonte gjërat kur isha fëmijë. Nuk arrij t’i shpjegoj asaj se si ndihem për disa gjëra. Jam zhgënjimi i saj.
Mos do ajo të jesh pak më praktike, teknike?
Këtu kam pasur fat. Jo. As vetë nuk është e tillë, është më shumë se kaq, por çka është nuk e kam te qartë. Do të mund të bëje më shumë?
Në këtë rast nuk e di çka është pak e çka është shumë. Mbase por gjithë kohën kam këto drej dilemash. Nëse paradite ndiej s’e kam bërë diçka të mirë, pasdite më shembet shpirti, nuk di çfarë të mendoj veç faktit se kjo botë mund t’ ia dilte fare lehtë edhe pa mua.

....

Jam magnet për idiotët. Herë- herë i largoj me shpejtësi të madhe nga jeta, herë-herë ngulitem mirë e mirë në ta sa shpirti fillon e më tkurret.
E bën nga mirësia?
Jo gjithë. Ka raste për shembull vuaj por nuk largohem. E di pse? Sepse e kam kureshtjen deri ku ata mund të të marrin hapësirën. E atëherë kur mbështetem për muri- e atëherë- përdorë atë armën time të injorimit total e cila jep efekte po dhe njëfarë negativiteti në shpirt. Vuajtja vazhdon edhe pas largimit?
Po. Shumë bile.
Pse, do të supozoja që në kushte të tilla e ke hequr një barrë.
Jo. E mendoj pastaj s’e si ata rrinë gjithë kohën zgjuar për t’ua bërë të tjerëve ferr jetën dhe në këtë rast çfarë mund të bëjë shpirti të largohet nga ky ferr.
Janë idiotë çfarë mund të bëjnë tjetër?
Po ta shohim kështu sikur i amnistojmë.
Ikim tash. Të hyjmë brenda se po bien terri dhe po bëhet ftohtë. Të thashë që bluza ime po të rri mirë e sidomos kur i mbanë duart lidhur.
Sikur ta presim hënën, ajo do pak e do të dalë?



Balloja me maska

tregim nga

ANDRIN KABASHI

Mbrëmjet në atë kohë të vitit ishin me të vërtetë të ftohta, por gjithsesi ato nuk ndalnin pasanikët e mëdhenj të qytetit të organizonin ballot e tyre me maska. Doemos se në sallat e tyre të vallëzimit do ishte ngrohtë. Madje më ngrohtë sesa shtëpitë e rrënuara të varfanjakëve, të cilave pullazet dita ditës u rrëzoheshin nga shiu e dëbora që binte pa pushim. Në qytet, dallohej qartazi ndarja dhe pozita e klasave. Pasanikët kurrësi nuk do lejonin të jetonin në të njëjtin vend me lypsarët dhe të papunët.

T.Sh., një riosh që jetonte në zonën e klasës së mesme – emri i të cilit nuk u mësua kurrë për publikun e gjerë – qe ftuar në ballo nga e llastuara e shtëpisë me dritare të gjera, zonjusha Z. Atë natë ai u vesh dhe u pispilloi si më së miri, pasi që, nga ato që dëgjova, kish kohë të gjatë që kur ai kishte ndjenja të forta për zonjushën Z. Jo se i kish thënë ndokujt, por se kjo vërehej. Ishte tejet e dukshme një gjë e tillë dhe se tashmë, thuajse të gjithë e kishin kuptuar, por, që të tjerët ishin në dijeni, T.Sh. nuk kishte asnjë informatë.

Me t'u bërë gati, doli nga shtëpia dhe u nis për tek stationi i tramvajit që të shpiente gjerë tek vila luksoze e zonjushës Z në pjesën tjetër të qytetit lartë në kodër, aty ku jetonin pasanikët. Rrugët e qytetit ishin të pista, askush nuk merrej me mbarëvajtjen e tyre. Shumë shpesh mund të shihje ndonjë jashtëqitje qeni apo mace, mu aty, në mes të rrugës. Dhe imagjinoni se si do vihej re në borën e bardhë e të pastër. Ugh! Kjo me të vërtetë ta shpif! Por fundja asgjë nuk e pengonte T.Sh.-n, në rrugën e tij për tek stationi i transportit publik. Iu desh të priste afro njëzetepesë minuta në të ftohtin e dimrit, që tramvaji i radhës të vinte. Dridhej e shkundej që të mbante veten ngrohtë sado pak, por besoj se, ajo çka me të vërtetë e mbante ngrohtë, ishte mendimi se për pak çaste do takonte zonjushën Z, në hollin e sallës së ballos.

Vagoni ishte i zbrazët. Askush nuk udhëtonte nga klasa e mesme për tek pasanikët në atë orë të natës. Bile, edhe gjatë ditës, kjo linjë nuk ish se posedonte edhe aq shumë udhëtarë.

Udhëtimi ishte i qetë. Nuk dëgjohej asgjë tjetër pos lëvizjes së rrotave nëpër shina. Ah, po! Një mizë e fëlliqur zukaste sa të mundte. Ishte irrituese! Ajo zukatja idiote të pengonte tej mase kur insekti i vogël me dy krahë kalonte pranë veshëve të tu, thua se e bënte me qëllim. Por fal Zotit, edhe kësaj i erdhi fundi! Vagoni u ndal mu përballë vilës luksoze me dritare të gjera. Vetëm një trotuar i vogël ndante hyrjen kryesore të vilës, me rrugën në të cilën qarkullonin tramvajet dhe automjetet e ndryshme.

“Natën e mirë!” – tha T.Sh. duke ngritur pak kapelën në shenjë respekti për shoferin plak, por ai as që mori mundin të kthehej e ta shihte se ç'bëri udhëtari i klasës së mesme. Ai vetëm hapi derën e vagonit, priti derisa T.Sh. të dal, dhe më pas me një vrull të çuditshëm, nisi vagonin për t'u larguar sa më parë që të jetë e mundur.

Kangjellat e vilës me dritare të gjera ishin të mëdha. Një riosh i klasës së mesme nuk qe mësuar të shoh aq shumë përdredhje metali vetëm e vetëm për të zbukuruar hyrjen e një shtëpie. Shkallët ishin të pjerrëta dhe të lëmuara. Ishin të punuara me mermer të bardhë, ku në krye të tyre, qëndronte porta e hapur nga e cila dukeshin pasanikët duke vallëzuar brenda. Muzika dëgjohej gjerë jashtë në rrugë. Ishte e këndshme. Më duket se thanë që atë natë u luajtën disa nga valset e Strausit të Dytë.

T. Sh.-n tashmë e kishin kapluar emocionet, dhe me një frymë, pa një pa dy, u gjend në krye të shkallëve. Salla ndrinte nga abazhurët e qelqtë që ndrinin fort.

Gjithçka dukej mahnitëse, derisa ai pa vashën e re, zonjushën Z. Faqet filluan t'i skuqeshin, goja ju tha dhe trupi nisi t'i dridhej.

Zonjusha Z lëvizte sa andej – këndeje duke mirëpritur mysafirët, por, kur rastësisht u ndesh me rioshin T.Sh., ajo u step dhe gota e verës i ra nga dora duke ju thyer në pllakat e bardha të sallës. “Kush futi varfanjak në shtëpinë time?!” – bërtiti me të madhe dhe me një zë të shtjerrë e llastuara e pasanikëve.

Muzika u ndal!

Të gjithë të ftuarit kthyen kokat kah zonjusha Z dhe rioshi T.Sh.

Ishte një siklet i madh! T.Sh. u mundua të arsyetohej – gjersa shihte se si pasanikët nën maskat e tyre të ndryshme e shihnin me përbuzje dhe me neveri djaloshin e klasës së mesme. Sytë e tyre dukeshin njëllor si sytë gjakatarë të ujque të egër, që me ëndje shohin prenë e tyre se si ajo shijon momentet e fundit të jetës, përpara gllabërimit të etur nga gojë të pikojnë jargë – por nuk ia doli dot. Vetën e gjeti të hedhur në shkallët e bardha prej mermeri të cilat në fillim i admiroi aq shumë. U mundua të ngrihej në këmbë, por rrëzohej sërish. Ashtu, këmbadoras dhe duke shikuar se mos po i vinte kush nga pas, luante këmbët sa më shpejtë që të mundej, të dilte nga ajo vilë e mallkuar.

Në kokën e tij nuk dëgjohej asgjë tjetër veçse të qeshurat e pasanikëve dhe një e bërtitur me një zë të shtjerrë – “Jashtë!”. Mezi hapi kangjellat, duke ia mësyre rrugës, por, nuk arriti të dëgjoj borinë që po binte fort. Ishte një nga makinat e pasanikëve, që po vinte me shpejtësi të madhe për tek balloja e zonjushës Z.

Trupi i rioshit T.Sh. u hodh shumë larg nga goditja e asaj veture. Kish rënë poshtë kodrës ku gjendeshin vilat luksoze të pasanikëve – kështu të paktën besojnë shumica e qytetarëve tjerë të këtij qyteti, pasi që, ende nuk është gjetur as edhe një shenjë nga trupi i rioshit të vrarë.

23. 10. 2020 – Prishtinë



‘Në një nga ditët e ardhshme, me të dalë nga shkolla, do të shkojmë te pishinat publike,’ them unë. ‘Të pëlqen ideja?’

‘Sot?’ pyet ajo.

‘Sot ke për të shkuar te mami,’ them unë. ‘Është e premte.’

Ajo përpiket që ta zhblllokojë rripin e sigurisë; butoni, herë pas here, është problematik, dhe për më tepër ajo nuk është mësuar të ulet përpara. Më në fund, unë i vij në ndihmë. Oborri i shkollës është i mbushur me fëmijë; është pushimi i parë.

‘Maja,’ them unë. ‘Si thua, do ta përqafosh babin?’

Ajo është e mpirë, por gjithsesi më lejon ta përqafoj. ‘Më fal,’ them unë, dhe filloj nga e para duke i përsëritur fjalët, të paktën, tre herë. E lejova ta veshi fustanin vjollcë, pavarësisht se bën akoma shumë ftohtë. Herë pas here, jam përpjekur më kot që t’ia lidh flokët gërshetë, gjë që e mërzi shumë, edhe pse ajo e di që Kathinka është vetmja e cila mund ta ndihmojë në këtë punë. Një faqe i është buhavitur, por këtë nuk do ta kisha vënë re po të mos e dija se çfarë ka ndodhur. Nuk e besoj.

‘Mund të largohem tani?’ pyet ajo.

Qëndroj ulur pa kurrfarë dëshire për të folur, por më në fund, miratoj me kokë. Si ngaherë, ajo e përplas derën me forcë pas vetes, ndërsa unë filloj të kërkoj. Çantën e shkollës ngjyrrë rozë me stampën e Elsa-s nga filmi *Frozen*, si edhe zverkun të mbuluar nga flokët e saj të imtë që është shumë e vështirë për t’i lidhur gërshetë. Kështu, unë nxjerr veturën nga parkimi dhe marr rrugën poshtë drejt autostradës ku dhe përfundoj i bllokuar në mes një vargu të gjatë makinash.

Kohët e fundit, çdo mëngjes Maja nxjerr trikon e leshtë për ta veshur në shkollë. Është një veprim që përsëritet shumë herë. Pulovra nuk i pëlqen, pantallonat gjithashtu. Shtratin e vet nuk e honeps. Dëshirë t’i pastroj dhëmbët nuk ka, sepse pasta e dhëmbëve nuk është e njëjta me atë që ka në shtëpinë e mamasë.

‘Edhe këtu në shtëpinë tënde je,’ i them unë. ‘Në shtëpinë e babait.’

‘Jo, nuk është kështu,’ përgjigjet ajo.

Ajo hedh shkëlma në drejtimin tim, më shtyn dhe më shan, ‘baba i keq, baba i keq.’ Ajo nuk lodhet kurrë, shkëlmon, ulërin dhe këlthet me një forcë natyrore sa herë që e bën këtë. Unë i bërtas, më bëhet sikur stomaku më merr zjarr, duart dhe fytyra më përvëlojnë; nuk e di se nga më vjen kjo, godas murin, ndërkohë që peizat e fytyrës më tendosen çdo mëngjes, çdo mëngjes të mallkuar, çdo mbrëmje kur ajo bëhet gati për të fjetur. ‘KUR DREQIN DO T’I VESHËSH PIZHAMAT DHE DO TË BIESH PËR TË FJETUR?’ Acarimet më kanë lodhur. Britmat nuk i duroj dot më. Ndjehej i dërrmuar. Trupi po më shkërmoqet. Koka më buçet. Kam nevojë për qetësi. Çdo mëngjes, gjatë rrugës për në shkollë çirremi të dy; në punë arrij gjithmonë me vonesë. Sa herë që e kthej te Kathinka, ajo i ngjitet mamasë pas trupit të hyrja e shtëpisë tek i thërret ‘Mammaaa! Sa shumë më ke munguar!’ Këtë e bën me një zë të dhimbshëm, a thua se e kam keqtrajtuar, ndërsa Kathinka është pothuajse e gatshme të më drejtohet me një zë fishkëllyes dhe të më pyes se çfarë ka ndodhur; i them se nuk ka ndodhur absolutisht asgjë, por e shikoj që ajo nuk më beson.

Sa herë që takohemi, nuk flasim për asgjë tjetër veçse për Maja-n. Nuk zëmë në gojë as ekonominë, as avokatin, por as edhe Nina-n. Këtë të fundit jo që jo. Tek rrijmë tek dera, flasim vetëm për takimin me prindërit dhe rrobat e palestrës, ja, kështu ia dalim mbanë ne. Maja i qëndron ngjitur Kathinka-s dhe i rrëfen asaj, në një mënyrë argëtuese, gabimet që kam bërë unë.

‘Babi harroi të m’i jepte me vete rrobat e palestrës, po, ai harroi,’ thotë ajo tek shikon Kathinka-n plot shpresë, ndërsa Kathinka, sikur t’i ketë humbur të gjitha shpresat tek unë, më buzëqesh. Në të vërtetë, ajo duket e kënaqur, e kënaqur, ta marrë dreqi ta marrë.

Që herët në mëngjes, gjithçka shkoi mbrapsht. Ajo përmbysi kartonin e qumështit, i cili, u derdh i gjithi në dysheme. Unë shkela mbi të. Ushqimin e paketuar që ajo do ta merrte me vete në shkollë nuk po e gjeja dot, ndërkohë, ajo angullinte se unë isha trundryshkur dhe një baba i keq, i keq, i keq. Tek po qëndronim në korridor dhe bëheshim gati të dilnim jashtë, me njëzetë minuta vonesë, ajo filloi t’i hiqte getat që kishte veshur.

‘Maja, mos fillo prapë me këto tani,’ thashë unë.

‘Nuk dua t’i vesh getat,’ tha ajo. ‘Ato më hanë.’

‘Getat janë shumë të bukura,’ thashë unë. ‘Dje i veshe.’

‘Nuk dua t’i vesh!’ ulëriti ajo.

U përpoqa që ta mbaja nga krahët me qëllim që të mos e lejoja të zhvishej. Vijuan britma, ulërima, shkëlma. U inatosa aq shumë, sa po më dridheshin duart, stomaku më digjte; tek qëndroja i përkulur mbi të, ndjeva pështymën në të dy cepat e gojës dhe përsëri shkela me këmbë getat e saj, ndërkohë që ajo ulërinte. ‘Dua të shkoj te mami,’ bërtiste ajo, ‘dua të shkoj te mami.’ Në momentin që e lashë pak më të lirë, ajo

Më fal, më fal, më fal

tregim nga

MARIE AUBERT

më iku sërish nga kontrolli, dhe duke i marrë me vete getat, goditi me këmbë një radhë me këpucë por dhe çizme që i degdisi në të gjitha qoshet. Aty, e godita, fort. Shuplaka e kapi te mollëzat e faqes dhe te syri i majtë. Ajo humbi ekuilibrin dhe për pasojë përplasi pjesën e pasme të kokës te faqja e murit ku varen xhaketat. Goja i mori për poshtë në njërën anë, më pas, u dëgjua një rënkim i gjatë. ‘Më iku,’ mendova, dhe qëndrova në këmbë pa lëvizur, me sytë mbi të. ‘Më fal,’ thashë unë. Gjoksi dhe stomaku më kishin marrë flakë. ‘Më fal, më fal, më fal, më fal.’ E mora në dorë dhe e tunda. ‘Më fal, më fal, më fal, vogëlushja e babit. Nuk doja ta bëja këtë, nuk kisha ndërmend, nuk doja ta bëja këtë. Më fal, humba durimin. Nuk duhej ta kisha bërë kurrë një gjë të tillë, nuk duhej ta kisha bërë kurrë këtë.’

Më pas, gjeta një qese me copa akulli në frigorifer, e futa në një shami dore dhe ia vendosa mbi sy. Pallton e dimrit e mbante akoma të veshur. Në frigorifer gjeta një coca-cola bajate dhe mbusha një gotë për të, si një idiot.

‘I kam larë dhëmbët,’ tha ajo duke e larguar gotën nga vetja.

Sa nuk shpërtheva së qeshuri nga përgjigja e saj, sa e zgjuar, dhe sa e mirë që u tregua.

‘E shikon, tani kam për t’u vonuar,’ tha ajo tek qëndronte ulur dhe ndryste syrin me qesen e akullit.

‘Do dërgoj një mesazh,’ thashë unë.

‘Çfarë do të shkruash?’ pyeti ajo duke më hedhur një shikim vjedhurazi me syrin tjetër. Goja e saj ishte shumë e vogël.

‘Do të shkruaj se sot u zgjuam me vonesë,’ thashë unë. Ajo nuk foli.

Mësueses së saj i dërgova një sms. Përshëndetje miqësore dhe emoji me fytyra që buzëqeshnin. ‘Dreqi e marrtë,’ thashë unë, tek ndjeva një të përzier në të gjithë trupin. I përkëdhela flokët. Floku i saj është shumë i butë. Ajo mbështeti fytyrën në të dyja duart dhe hodhi shikimin nga tavolina.

‘Nuk duhej ta kisha bërë kurrë atë që bëra,’ thashë unë. Askush nuk ka të drejtë të veprojë kështu. Këtu përfshihem dhe unë.’

Më në fund, e mora pranë vetes dhe e ula në prehër; ajo mbështeti kokën në gjoksin tim dhe më mori në gushë. E largova pak nga vetja dhe e pashë me kujdes. Faqen e kishte akoma të kuqe. ‘Mund t’i ngeli edhe shenjë,’ mendova. Ndoshta, kur ta çojë me makinë te Kathinka, shenja do t’i duket.’

Gjendja e trafikut nuk kishte pësuar asnjë ndryshim. Duhej t’i kisha thënë se nuk duhej të fliste për atë që kishte ndodhur. Pa shiko ku më shkon mendja. Marr Nina-n në telefon, dhe është pikërisht ajo që e ngre receptorin.

‘Hej, i dashur,’ thotë ajo.

Kisha shpresuar se telefonin do ta ngrinte dikush tjetër. I them se jam përsëri me vonesë për mbledhjen e mëngjesit, kurse ajo qesh dhe më pyet nëse gjërat përsëri kishin dalë jashtë kontrollit.

‘Po,’ përgjigjem unë. Asaj i kanë pëlqyer gjithmonë shakatë.

‘O zot,’ thotë, ajo. Ajo nuk është aspak naive.

‘Nuk është aspak e lehtë për të,’ them unë.

‘Sigurisht që jo,’ thotë ajo pa vonesë. ‘Këtë e di mirë.’

Tek jam duke parkuar, më vjen ndërmend ideja se me t’u futur brenda në shtëpinë e Kathinka-s, Maja do të vë ulërimën, ‘babi më rrahu, babi më rrahu.’ Ajo nuk ka për të ardhur më që të rri me mua, në shtëpinë time, Kathinka nuk ka për ta lejuar një gjë të tillë, mundet që të marrin telefon nga shkolla, dhe madje, edhe nga organizata e mbrojtjes së fëmijëve; më merren mendtë, kam qëlluar me pëllëmbë vajzën time.’

Kur arrij në punë, mbledhja e mëngjesit sapo ka mbaruar. Të pranishmit dalin nga mbledhja me kupat e kafesë dhe laptop-ët nëpër duar. Në ajër ndjehet aroma e së premtes, për pushimin e drekës, qeraset tortë. Nina më jep një ledhatim të shpejtë tek më kalon pranë. Stein-i më përshëndet me kokë, ndërsa unë i kërkoj të falur.

‘Nuk ka asnjë problem,’ thotë ai dhe më godet lehtë

mbrapa shpatullave. ‘Nganjëherë ndodh edhe kështu, ja, mblidhemi të gjithë së bashku.’

A thua se mua më kishin ardhur periodat. Asgjë nuk po shkon mbarë. Të tjerët merren me projekte për të cilat nuk kam asnjë lloj interesi deri në momentin e fundit. Së shpejti, do të ma vënë vizën, për shkak të Maja-s, ndërsa unë ndjej turp që mendoj gjëra të tilla. ‘Më fal,’ them me vete, është e vetmja gjë që them gjatë gjithë ditës, ‘më fal, më fal, më fal.’

Nina futet vjedhurazi në apartamentin tim me dëshirën që ne të puthemi, ndërkohë, unë ndërroj kafën në makinën e kafesë në një cep të kuzhinës.

‘Do të vish tek unë pasi ta çosh Maja-n në darkë?’ pyet ajo.

‘Patjetër që po,’ përgjigjem unë.

Në apartamentin e saj mbrëmjet janë të bukura. Ne gatuajmë, pimë verë, bëjmë dashuri dhe më pas shikojmë një film. Të jepet përshtypja se je me pushime. Në raste të tilla, përpara se unë të mbërrij aty, ajo bën shumë, pastron, merr pluhurat me fshesën e korrentit, blen verë të shtrenjtë, fileto, si edhe përpiket të tregohet e shpenguar. Duket shumë qartë se ajo mezi pret që të më shikojë, dhe kur e takoj mëngjeseve duket se është në siklet që unë t’i them diçka tek e cila ajo të mbështetet fort, t’i them se unë dua që ajo ta takojë Maja-n, dhe se ne të dy do të fillojmë të bashkëjetojmë në të njëjtin apartament.

‘Më dukesh shumë i lodhur,’ thotë ajo tek më puth në anë të buzëve.

Më pushton dëshira që t’i them se kot sorollatesh dhe ëndërron të bësh fëmijë me një abuzues fëmijësh.

E vështroj tek qëndroj i ulur para kompjuterit duke u shtirur se po punoj. Ajo është ulur pranë dritares, e shikoj në gjysmë-profil. Ja, kështu e pashë atë gjatë gjithë stinës së vjeshtës vitin e kaluar. Tani ajo është më e imët; mund të them se kjo nuk është gjë e mirë për të, vërtet, dhe sikur të isha i aftë, unë do t’i jepja fund çdo gjëje me të. Çfarë di Nina, me gjithë librat e saj, me hyrjen e saj të vogël me dy dhoma dhe shoqet e veta me foshnje të vogla, stërvitjen që bën në palestër, dhe kohën që disponon? Çfarë di ajo për mua, Kathinka-n, Maja-n dhe për të gjitha ato që ne përfaqësojmë?

Jam duke pritur në makinë jashtë shkollës. Fëmijët dalin jashtë duke rendur, tre nga tre, dy nga dy, dikush vetëm, ngadalë dhe të ndrojtur, të tjerët në grup duke ulëritur. Maja është futur në mes dy vajzave, ose është pak e tërhequr më mbrapa, për këtë nuk jam i sigurt. Ajo futet në makinë dhe përshëndet. Gërshetat pothuajse i janë prishur plotësisht, ndërsa kordelet i qëndrojnë me vështirësi mbi flokë.

‘E kalove mirë sot?’ e pyes unë.

‘Mirë,’ thotë ajo.

Është ajo Maja e zakonshme, por ndoshta jo plotësisht.

‘Me kë e kalove pushimin e madh?’

‘Me Mia-n dhe Selma-n.’

‘Çfarë bëtë gjatë pushimit?’

‘Luajtëm me litar.’

‘Oh, sa mirë.’

‘Unë kërceva me litar më shumë se vajzat e tjera,’ thotë ajo tek më shikon drejt e në sy për herë të parë. Gjithmonë e jep veten kur ndjehet krenare, nuk e fsheh dot. Buzëqeshja e saj e përmbajtur përshkon gjithçka tej për tej, ndaj si unë dhe Kathinka, nuk mund t’i bëjmë ballë.

‘Je shumë e zonja!’ them unë me një entuziazëm të tepruar dhe e përgëzoj duke i rrahur supet lehtëazi.

‘Çupa ime!’

Faqen e majtë e ka akoma të fryrë. Nuk ka mundësi të gjendet sy në botë që të mos ta vë re atë. E vështroj me kujdes nëpërmjet pasqyrës tek ngas makinën, dhe përpiqem ta vë veten në vendin e Kathinka-s në momentin kur ajo do ta takojë, pa ditur asgjë. Ndodhem me vajzën time pas një dite të zakonshme, por nuk po ia dal dot, jam shumë i inatosur. Mendoj për zërat e lartë, ngërdheshjet, avokatin dhe shërbimin e mbrojtjes së fëmijëve. Ndez dritat e parkimit, fus makinën në një xhep të zbrazët ku zakonisht pushojnë autobusët, dhe freno.

‘Ke folur sot me ndonjë tjetër për këtë?’ e pyes unë.

Ajo mohon me kokë dhe hedh shikimin nga dritarja, me kokën tashmë të ulur e të mbështetur mbi gjoks.

‘Është më mirë të mos i themi mamasë për atë që ndodhi,’ them unë. ‘Si ti edhe unë, i kemi vënë kapak kësaj pune, apo jo? Mami, ama, mund të mërzhitet dhe ta keqkuptojë, kështu pra. Si thua, Maja?’

Ajo i heq kordelet dhe tërheq flokët.

‘Në qoftë se ajo të pyet, thjesht, mund t’i thuash se u vrave duke luajtur me litar,’ them unë.

Janë fjalë që të lënë një shije të keqe, megjithatë unë i thashë ato.

Ne mbërrijmë te Kathinka me makinë. Në shtëpinë tonë. Unë ia mbaj çantën Maja-s tek i ngjitemi një rrugice të shtruar me zhavorr, ndërkohë, Maja vrapon përpara. Kathinka hap derën para se unë të arrij t’i bie ziles, ndërsa Kathinka e përqafton me gjithë fuqinë e saj. Asgjë nuk ka ndryshuar. Aroma që ndjen kur futesh në korridor, pikturat dhe fotografitë që sheh mbi mure, si edhe çelësi i dritës që varet lirshëm. Këtu ndodhet gjithçka nga ajo që dikur ishim ne, por unë nuk banoj më këtu, ndaj nuk i heq këpucët në korridor dhe nuk futem brenda që të ulem në divan, për këtë arsye, ai që mungon, jam unë.

‘Kaluat mirë?’ pyet Kathinka. Zëri dhe buzëqeshja e saj janë neutralë.

‘Po, mirë kaluam,’ them unë. ‘Në çantë do të gjesh programin e ri të javës.’

‘Bukur,’ thotë ajo. ‘Po ti vogëlushja ime, kalove mirë? Ç’ke pësuar kështu në faqe?’

Ajo e merr Maja-n në gushë.

‘U vrava duke luajtur me litar,’ përgjigjet Maja.

‘Ah,’ bën Kathinka.

Maja heq këpucët dhe i vendos ato me kujdes në vendin e tyre. Zverku i saj është i hollë dhe i vogël. Ajo kthen kurrizin dhe m’i ngul sytë në kohën që Kathinka po ia var xhaketën. Ajo nuk ma ndan shikimin.

Përktheu nga norvegjishtja: Aristidh Shqevi
Oslo, 26.09.2020



Shoku yt, Baba

tregim nga

ANDREAS DUSHI

Përgjatë historisë, nuk besoj të ketë ndodhur ndonjë proces më vështirë i realizueshëm sesa emërtimi i ndjenjave. Si është shpjeguar për herë të parë frika, aq sa të gjithë të vendosnin ta quanin njëloj? Po mërzia, lumturia e sa e sa të tjera? Nëse bini dakord (njëri me tjetrin se me mua kurrë!) që edhe dashuria është ndjenjë, atëherë themi lehtë se ky proces nuk ka mbaruar, por le ta lëmë jashtë kësaj trajtese *artistike* këtë temë, frymëzuesen supreme të *artit* në tërësi.

Kur njeriu ka ndjerë mall për të parën herë, si ka qenë? Për kë u krijua kjo ndjenjë? Besoj një vetëdije shoqërore e ka pasur, padiskutim. Ndoshta edhe intelektuale sepse, t'ja dalësh të krijosh me dikë një raport intim, duhet ta perceptosh mënyrën e tij të menduarit. Pastaj, pavetëdija afektive u vendos këmbën në grykë të gjitha vetëdijeve dhe malli buron diku nga frymënxjerrja plot vështirësi. Si tymra të bardhë (u zgjodh Papa?!), ngërthehen të gjitha, aq fort shtrënguar sa të mos shquhen dot.

Nuk di të them nëse sa po shkruaj është *tregim a provë*. Besoj të jetë një rropatje për të rrëfyer diçka të vërtetë fshehur në personazhe me kompleksitet të dyshimtë, ndërtuar me pendë nga flatrat e shumë kerubinëve.

Në Shkodër, një djalosh në klasën e gjashtë, i bie diku dymbëdhjetë vjeç, nuk kishte shokë. As shoqe. Askënd! Në klasë, ulej përkrah psherëtimave plot bezidsje. Në oborrin e pallatit, ulej përkrah oshtimave plot tallje. Vetë as nuk psherëtinte, as nuk oshtinte. Veç rrallë, ndonjëherë kur qante me të madhe dhe lotët i rridhnin mbi fromën e dalë nga psherëtima, për tu nisur mandej kushedi se ku, shtyrë nga forca e oshtimës. Por kjo i ndodhte kur ishte vetëm. Të qartësohemi: pse nuk kishte shokë e shoqe, nuk do të thotë se gjithmonë ishte vetëm. Herë pas here, ulej kërrusshëm në prehrin lëndëfole të të atit. Nga aty, bisedonte më shumë se mendonte.

Djaloshit shkodran pa shokë, flokët ia rregullonte i ati. Tani, meqë nuk jeton më në Shkodër (te shokët s'është se ka ndonjë ndryshim të madh), flokët nuk i rregullon. Ai, veshjet i blinte me të atin dhe edhe tani, po me të i blen. Nën vështrimin ngjyrëshpresë të së ëmës, hante me të atin, ndërkohë që ajo ngrihej herë pas here për të sjellë sa një gjë, një tjetër. Sa i mungojnë djaloshit këto dreka.

Djaloshi u rrit e u bë adoleshent. Sikurse thashë, shoqëria s'pati ndonjë ndryshim të përmendshëm, por kjo nuk e shqetësoi. Kuptoi se shoqëria ishte përjetim dhe si i tillë, mund të gjendej në çdo njeri. Ai e kërkonte dendur jashtë familjes sepse afrimiteti me to i ngjante natyral, rrjedhë normale e përroit të rrëmbyer të jetës. Por lexoi, mësoi dhe formësoi në mendje përqasjen e saktë të shokut. Atëherë kuptoi se asnjë çast s'kishte qenë pa të, madje gjithnjë pranë e më pranë tij. Filloi t'i thoshte vetes se rrobat s'po i blinte me të atin, por me shokun, sikurse pjesa më e madhe e djemve të rinj bëjnë. Në atë kohë, djaloshi u dashurua për të parën herë. Kujt i tha? Sigurisht, shokut!

Çfarë shoku! Ai la keq veten për t'i plotësuar nevojat djaloshit. Hiqte dorë nga argëtimi i tij që të argëtohej e dashura e djaloshit për të lumturar djaloshin. Sepse ai e dinte se djaloshit lumturia i rrinte në sytë e së dashurës! Sepse ai e dinte se djaloshi ishte budalla pasi e ndërtonte kështjellen e buzëqeshjes me rërën e

së përkohshmes. Kur dallga e zhgënjimit e rrënoi atë, shoku i ndenji pranë.

Mëngjeset e vrenjtura sillnin kumte vetmie nga dritarja e dhomës së djaloshit. I ati i sillte librin e fundit të Michel Houellebecq. Dedikimi në faqen e parë: Nga shoku yt, Baba!

Njësimi i shokut me babën është aq i hershëm, sa kujtesa e djaloshit në tentativë për tu burrëruar e shpreh paqartësisht në këtë tregim provë. E gjitha ndodhi me shpejtësinë e dritës, por edhe me butësinë e kalimit të saj mepërmes xhamit: ndikoi aq shumë pa cënuar asgjë! Edhe unë, ça tipi kam, flas në kohën e shkuar, thuase tani nuk ndikon!

Tani kur është larg nga shoku, djaloshit i është mbyllur në mendje një bylbyl plot vajë malli. Kënga e tij është aq e bukur për frymëzimin, sa është kob për atë vetë. Aq thellë në shpirt tejshpon sqepi i dëshpëruar i bylbylit, sa thërmon edhe cipën e asaj farës së përbotshme e të përhershme, të gjendur pavarësisht veçansisë së çdo njeriu diku thellë në bërthamën e qenies... Asaj fare që në brendi ruan grimcën e padukshme që bashkon të gjithë njerëzit e të gjitha kohërave, e cila brendashkruar ka materialin transhendent që na njëson me të gjithë frymorët e tjerë. Diku në orbitat e saj sillet trupi i paujë i mallit. E mu aty, djaloshit i jeton shoku i tij, Baba.

Jetohet dot pa ujë? Aty, djaloshi nuk lejon të ketë qoftë edhe një pikë, sepse do që banorët e atjeshëm të largohen sa më parë. Të kërkojnë vendqëndrim në një tjetër orbitë, aty pranë por edhe larg, para se të treten në harresë. Shoku i tij, Baba është i ri dhe krejt i përkohshëm aty, këtë e di dhe djaloshi por prap: i duket padrejtësi të mbajë mbi shpatullat e zemrës qoftë edhe një çast ndjenjën e mallit për të atin.

Djaloshi mendonte se ishte shkrimtar. “Do të” vështirë ta thoshte sepse për të, e ardhmja është realitet i pakuptimtë, ashtu sikurse çdo *e paqenë* tjetër. Mandej, u bë me të vërtetë shkrimtar. Nga kush? Nga se? Vështirë ta thoshte, nuk e dinte! Pikërisht kjo është



arsyeja pse u largua nga i ati: në një shkrimtar, ndikimi i të atit duhet të jetë shkërrmoçës. E bezdiste shumë mbështetja e tij e edhe më, e shqetësonte gëzimi i tij për arritjet e të birit. Me domosdo donte të kishte një Herman, pasi mendonte se veç ashtu mund të bëhej Kafkë. Por harronte se mes tij dhe Francit, lidhjet jetonin veç në vdekje.

Sërish, ai nuk ka shokë. Jeton mes katër mureve ngjyrë panë brenda të cilëve nuk ka asgjë të ëmbël, veç hidhësi vetmie. Nuk mendonte asnjëherë se kryeqyteti do të qe një *kalvar*¹ nëpër të cilin duhej kaluar pa asnjë *Simon Cirene*², me vështrimin e ngulur në Golgotën pa kryq. Simoni i qe dërguar Krishtit nga Ati. Po djaloshit, kë do t'i dërgojë i ati?

Nuk mendoj se *atësia* është një atribut i kotë a i rastësishëm i Zotit. Këtë mëyrë të menduari ma ka formësuar shoqëria me djaloshin. Shoqëri e largët, platonike e ndërtuar në substancën e paperceptueshme prej shqisave e cila ruhet në cipën prej vese të shpirtit. Sikur shprti i djaloshit të qe me të vërtetë gjethe, e jeshilta prej klorofili domosdo do t'i buronte nga empatia për shokun e tij, Babën.

I ati i dërgoi vetveten. Sa herë kishte nevojë për diçka, prania e tij nuk e ngushëllon, por e ndihmon, e plotëson. Kur në ajrin prej bloze të kryeqytetit djaloshi hap sytë, pasi një rreze e lehtë malli për Shkodrën i përshkon atë pjesë që akoma vijon të ëndërrojë mbi vargun e Koliqit “ajri krilstaluer i Shkodrës”, këmbanat bien me vrull në këmbanaren që mend e kap me dorë nga dritarja. Sa i ngjan e gjitha me zërin e të atit. Vallë do ta mendonte Vivaldi se qashtërsia e lakores së muzikës së tij, ndonjëherë do të mund të luhej prej këmbanave të rënda? Po baba, vallë e ka menduar se prania e tij e pupëlt dhe e përgjinjeshme pranë djaloshit do të tregohej në rëndësën kërrusëse të një tregimi? Nuk besoj!

Djaloshi tani dëshiron vetëm diçka: Ta gëzojë të atin. Po të mos e bëjë, shoqëria mes tyre i ngjan e pasinqertë. Ai vetëm merr, pa dhënë asgjë, asnjëherë. Dhe është me shumë fat sepse shoku i tij, baba, gëzohet shumë thjesht. Një kafe në mëngjes, buzë rrugës ku sa herë shkel, shkërmoç gjetet vjeshtarake të kujtimit. Një drekë gjatë së cilës shohin veten të pasqyruar mbi sipërfaqen e liqenit të qytetit, me cënime të rralla falë valles së ndonjë peshku. Një darkë me pak verë të kuqe nën qiellin ku e bardha e yjeve puplohet rreth ndriçimit të hënës. Kaq... Një ditë e tillë për kushedi sa vjet përkushtim të kryer për hir të dashurisë.

Tani kam pjesën më të vështirë të tregimit. Djaloshi më ka kërkuar t'ia përshkruaj të atin! E shoh qartë, sa herë dua, kur sytë i drejtoj në një bimë shtatlartë që rron në parvazin e jashtëm të dritares së shtëpisë së djaloshit. Sepse atë bimë, ai ia ka dhënë. Është aq e gjelbër, sa shpresa e pashuar për më mirë, më mirë, më mirë.

Jo, nuk mundem! Ndoshta ndonjë teoricient, fragmentin e mëposhtëm e quan *postmodern*, sepse unë si autor largohem dhe vendin ia lë personazhit. Nuk mundem dot ta përshkruaj shokun e djaloshit, babën... Le ta bëjë vetë djaloshi!

(çka djaloshi tha, nuk më pëlqeu, ndaj po e heq, po e fshij. kam përshtypjen se atë, shokun e tij, babën, është më e lehtë ta imagjinosh sesa ta tregosh)

Dhe unë, duhet ta lë me kaq sa nuk më ka thënë djaloshi t'i shkruaj edhe për të ëmën. E di se do ma thotë, por një tjetër herë. Sot le të njihni shokun tim, babën! Dua të them, shokun e djaloshit... Se mos mbeti ndonjë prej jush pa e kuptuar këtë alterego të paalegori.

1 Rruga që përshkon Krishti me kryqin në shpinë kur ngjitet drejt Golgotas, Malit të Kafkës në të cilin kryqëzohet.

2 Burri i cili ndihmon Krishtin të mbajë kryqin gjatë rrugës për në Golgota.

Parathënia e librit të Bashkim Shehut, "Liri Belishova dhe koha e saj - Idealizmi, humnerat e pushtetit, katarsis"

LIRI BELISHOVA DHE KOHA E SAJ

nga Prof. Diana Kastrati

Nëse do të përpiqeshim ta katalogonim në një gjini të përcaktuar veprën që sot po i paraqitet lexuesit shqiptar, mund të kishim ndonjë vështirësi në emërtim, gati *sui generis*. Pena e sigurtë, e konsoliduar, mjeshtërore e shkrimtarit, përkthyesit e estetit letrar Bashkim Shehu, na sjell kësaj radhe të konceptuar në një mënyrë moderne dhe mbase jo fort të rrahur në lëminë e letrave shqipe, një vepër që mbart të gërshetuara sa tiparet e një analize të mirëfilltë studimore të karakteristikave të komunizmit shqiptar e atij ndërkombëtar të ish-kampit socialist, por po aq edhe rrugëtimin biografik tragjik të njëjës prej protagonistëve të skenës politike shqiptare të pas vendosjes së komunizmit në Shqipëri, Liri Belishovës. Por, rasti Belishova, është vetëm ilustrimi i një analize të thelluar, shtrënguese, të kontekstit politik e ideologjik të kohës në Shqipërinë që rrëshqiti shumë shpejt në totalitarizëm. Vepra na vjen si një mozaik i plotë analizash politike, gjeopolitike, përsiatjesh sa filozofike aq edhe letrare e psikanalitike të cilat e kornizojnë, por duke mbajtur në qendër të tyre Belishovën si një ndër shembujt më dramatikë ku mbrojtësja dhe bija e ideologjisë komuniste, shndërrohet në viktimën e saj.

Paradigma e veprës jepet që në fillim kur autori citon Milan Kunderën se "Totalitarizmi nuk është vetëm ferri, po është edhe ëndrra e parajsës: ëndrra e stërlashtë e një bote ku të gjithë jetojmë në harmoni, të bashkuar në një vullnet të vetëm dhe në një fe të vetme...". Prej këtu vijnë e shtjellen në një ndërthurje interpretuese sa filozofike, aq edhe letrare, nëpërmjet citimit të një galerie erudite autorësh si Peter Weiss, William Faulkner, Bernard Tönnies, Jorge Luis Borges, Fëdor Dostoevskij, Evgenij Aleksandroviç Evtušenko, Ágnes Heller, Hannah Arendt, Raymond Abellio, Isaac Deutscher, Tony Judt, François Fejtö, Umberto Eco, George Orwell, një seri konceptesh filozofike si ai i kohës, të kaluarës, i kujtesës, i idealit, i aspiratave njerëzore. Ndër këto aspirata, komunizmi paraqitet si i tillë për të rinjtë e Rezistencës: "ishim si të droguar" – i shprehet vetë Belishova shumë dekada më vonë. Kjo "drogë" e ëndrrës së premtuar për barazi, do ta kishte efektin aq të gjatë në "venat" e protagonistes tonë, po aq sa të një pjese të mirë të këtyre të rinjve, sa që do t'i duheshin dyzetë e kusur vjet për të kuptuar se e Keqja fatale në Shqipëri nuk qëndronte thjesht tek sistemi, por edhe tek vetë njerëzit që e aplikuan e u aplikuan në atë sistem. Një konstatim ky që na ndërmend Dostoevskijn i cili, disa vite pas suksesit të botimit të parë të romanit të tij "Demonët", i shkruante në letër botuesit të tij se: "tek romani *Demonët* është një sasi personazhesh që m'i kanë kundërshtuar si tërësisht pjellë e fantazisë. Por në vijim, më besoni apo jo, që të gjithë janë konfirmuar nga realiteti".

Nëpërmjet një shpjegimi të argumentuar hollësisht dhe me imtësinë e kirurgut, autori Shehu na sjell në paradë faktet e vendosjes së terrorit dhe totalitarizmit të komunistëve shqiptarë që në kohën e luftës së rezistencës, një rrugëtim i gjatë, i programuar gati në përsosmëri e që në rrënjë, i strukturuar thuajse me akribi shkencore. Arkitektët e këtij terrori na vijnë me një identikit qartësisht të lbyrët nga autori i kësaj vepre, duke filluar nga kryearkitekti Enver Hoxha e, duke mos kursyer asnjë, as të atin e tij, Mehmet Shehun, një nga emblemat e atij pushtet e sistem, si në të gjallë, por po aq me ikjen e tij nga kjo botë duke u shndërruar kështu në një legjendë permanente të mistershme. Ky

qëndrim i distancuar dhe objektiv i autorit, i cili nuk është thjesht hartuesi i veprës, por tek e fundit edhe dëshmitar e vuajtës i intrigave e tragjedi të kurdisura në "oborrin e mbretit", i bën nder të jashtëzakonshëm atij, po aq sa rindërtimit të kujtesës historike të një periudhe shumë gdhendëse për fatet e shqiptarëve. Ky rindërtim vjen e ndihmohet edhe falë nxjerrjes në pah të dokumenteve të kohës, si procesverbalet e plenumëve ku u vulos, u bë e u zhbë edhe fati i Liri Belishovës dhe e familjarëve të saj për pasojë. Pasojë e këtij totalitarizmi e terrori do të binin një e nga një Mustafa Gjinishi, Sejfullah Malëshova e më pas Naku Spiro me vetëvrasjen e tij, një varg i gjatë e i pafund shkëlqimesh e rëniesh pikiatë të një morie individësh besnikë të idealit komunist, por po aq edhe të figurës së Njëshit, Enver Hoxhës.

Në përshkrimin mjeshtëror të autorit Shehu të kësaj kurbe që po merrte përmasa gjigande brenda vetë strukturave më të larta partiake, më kobndjellësja mbetej asgjësimi absolut i përmasës vetiake, i individualitetit, i të menduarit ndryshe. Gati si në një manual me udhëzime, gjenden saktësisht të gjithë përbërësit e totalitarizmit: homologimi mendor e ligjërimor, krijimi i figurës së domosdoshme të "armikut", terrori si thelb e si formë, i sanksionuar tashmë nëpërmjet manipulimit gjuhësor, rrafshimi i opozitarizmit si koncept e si praktikë, dogmat.

Në këtë kuadër apokaliptik të situatës shqiptare në gjithë vitet e totalitarizmit, i cili i serviret masës me "pudrosje të sheqerosur" duke krijuar pikërisht atë iluzionin e parajsës të shprehur më lart nga Kundera, qëndron Liri Belishova, një ndër figurat më të keqpërdorura, një emër që ka hyrë në kujtesën historike të Shqipërisë për të mos dalë më kurrë. Fatkeqësisht, për tragjizmin që mbart kjo figurë komplekse.


Në rindërtimin e kalvarit të jetës së saj, autori e përshkruan atë si viktimën me efekte anësore të një trioje (e më shumë) faktorësh: personale, gjeopolitike

e të terrorit. Në një erashkë me reflektime, observime, analiza psikosociale e asocime letrare ku këto të fundit janë gjurma e pashlyeshme e shkrimtarit Shehu, ka gjetje shumë përfshirëse e gati shekspiriane, siç është rindërtimi i misterit të përndjekjes makbetiane të fantazmës të Naku Spiros, Enver Hoxhës. Të të njëjtit nivel gjithëpërfshirës e interesant, janë edhe përsiatjet e zbërthimit të personit të Liri Belishovës, në një çelës psikoanalitik, përsëri nëpërmjet letërsisë. Për të kuptuar sadopak momentin psikologjik e psikanalitik të rënies së dytë fatale të protagonistes Belishova, autori rindërtton në mënyrë imagjinare skenën e kthimit të saj në shtëpi menjëherë pas goditjes dërmuese në plenum, teksa shoqërohet nga shoferi i saj me makinë, duke ndërmendur pasazhin nga romani i Kadaresë "Dimri i vetmisë së madhe"; ndalimi i saj në një parfumeri (hera e parë që ajo blen vetë një të kuq buzësh), të shikuarit e botës që lëviz jashtë xhameve të makinës në një prag feste fundviti, pakuptimi i jetës dhe, ajo më e rëndësishmja, humbja e pandalshme e përfundimtare e saj si politikane e pastaj e të qenit grua. Ndoshta, përsiat autori, ishte hera e parë që Belishova aq e përkorë në të mbajtur, aq e rreptë në shpërfaqjen e feminitetit të saj, kupton rrrokullisjen e pashmangshme të femrës tek ajo, një humbje që nuk e kishte parashikuar mbase as ekzistencën e përmasës së feminitetit tek një grua e fortë si ajo. "Fillon zbritja e saj në ferr; për herë të dytë. Është vetëm tridhjetetë vjeçe. Dhe skena te pasqyra duke provuar një të kuq buzësh kur fillon kjo rënie më çon te një personazh i mitologjisë greke, Proserpina, nusja e perëndisë së botës së të vdekurve, e cila gjysmën e vitit qëndronte në ferr, gjysmën tjetër të vitit kthehej në botën e mbidheshme, për t'u kthyer pastaj sërishmi në ferr. Ndërsa për Liri Belishovën kjo zbritje e dytë në ferr do të zgjaste mëse çerek shekull".

E më pas, një e nga një, humbja e gjithçkaje, e afeksioneve familiare, e izolimit, e të qenit një hije, e banalizimit ekzistencial, e të mohuarit të të qenit një individ. Veçanërisht kjo! Belishova, në humbëtitë fizike, cerebrale e emotive ku e degdisin e ridegdisin, për herë të parë kupton se ka një raport që është vetëm unilateral: individ i përballë shtetit, ku ky i dyti bën padronin absolut në totalitarizëm. *Colpo di grazia*, humbja e së bijës, Dritës, vajzës mendjeplote, të talentuar, optimiste! Kurrë vdekja nuk të buzëqesh, por vdekja e një fëmijë, e një të reje, në ato kushte të një ferri dantesk, e shpien Liri Belishovën të reflektojë përtej kufirit të së pamundurës. Ajo i rrëfen autorit se si i biri, i ri, në internim i bente një pas një pyetje therëse mbi arësyet e zgjedhjeve të së ëmës. E aty nisin dyzimet e saj, zhgënjimet nga ai sistem, rëndimi psikologjik për "fajet" e saj ndaj familjarëve. Ajo, ateistja e bindur, mbërrin edhe cakun ekstrem të një gati "mea culpa", të "fshikullimit" të vetes për zgjedhjet e bëra, të luftës që rezultoi e gabuar për të mundur të Keqen, për të ndihmuar të dobëtit. Luftë, në të cilën u gjend sërishmi në anën e viktimave. Nga këtu buron edhe dënimi i vetes si dhe falja publike e saj. E vetmja nga i gjithë establishmenti që i mbijetoi atij ferr, që pati guximin moral të kërkonte falje. Por, njëkohësisht, nuk u përkul kurrë të shqiptonte para xhelatëve të saj fjalët e falenderimit kur të birin nuk ia përsërisin internimin, fjalë që ata donin t'ia shkëpusnin nga goja sepse këtu konsiston edhe triumfi i totalitarizmit, ta bëjë viktimën të flasë me ligjërimin e tij.

Shkronjësja e këtyre radhëve, e ka njohur personalisht këtë grua: një karakter i fortë, e pajisur me një inteligjencë të pazakonshme, me një formim kulturor solid, me një mendje të hollë e me një memorie të hekurt, me një optimizëm të pasqorë e për t'u patur zili, me një elokuencë prej dishepulleje të shkollës së retorikës greke. Duke e pasë njohur kështu, ajo që të lind mbase si pyetje e menjëhershme pasi e lexon këtë libër, është nëse Belishova, në vitet e fundit të jetës së saj, t'i ketë kuptuar realisht arësyet e të qenit komunist. E këtu të vjen në ndihmë monologu i famshëm "Dikush ishte komunist"¹ e satiristit të hollë italian, Giorgio Gaber: "Dikush ishte komunist, sepse ishte kaq ateist, sa që kishte nevojë për një Zot tjetër!"²

Tiranë, 15 shtator 2020



1 "Qualcuno era comunista".

2 "Qualcuno era comunista, perché era così ateo, che aveva bisogno di un altro Dio".



CLAIRE ADAM

MBI RRESHTIN E PARË IKONIK TË "NJËQIND VJET VETMI"

Koha kalon ndryshe në tropik

E kam lexuar shumë vonë veprën e Gabriel García Márquez-it. S'e shpjegoj dot pse më është dashur kaq shumë kohë për të lexuar një nga librat e tij: mbase ngaqë më dukej më shumë si një lloj detyrimi për të lexuar një laureat Nobel në pedestalin e burrave të sistemit letrar.

Më kujtohet që fëmijë në raftin e librave të prindërve *Njëqind vjet vetmi*: ishte fraza "njëqind vjet" që s'më tërhoqi: dukej sikur fliste për histori, një histori shumë të mërzitshme, pastaj edhe "vetmi" s'ngjante fare argëtuese. Imagjinoja se bëhej fjalë për një njeri që rrinte vetëm për njëqind vjet, duke folur pafund me vete pak a shumë si "Të rrosh a të mos rrosh?" Aty ishte dhe *Dashuri në kohën e kolerës*, sipas meje asokohe, duhej të ishte libër për kolerën. (Kishte shumë libra shkollorë mjekësorë në bibliotekë, prindërit e mi ishin të dy mjekë. Kisha shfletuar shpesh *Manualin e sëmundjeve infektive tropikale* dhe dija gjithçka për kolerën.)

Sidoqoftë, njëzet vjeçe, rastësisht po u hidhja një sy librave në gjuhën angleze në një librari në Amsterdam, mora *Njëqind vjet vetmi* dhe lexova fjalinë e parë. Lexova pjesën tjetër të paragrafit, pastaj deri në fund të faqes, dhe pastaj u ktheva të lexoj përsëri fjalinë e parë. E vura librin në raft dhe vijova më tej nëpër librari, por ndërkohë herë pas here hidhja vështrimin mbrapa vendit ku rrinte libri. U largova nga libraria duarbosh dhe vazhdova jetën, por, gjatë njëzet e ca viteve të ardhshme, fjalja vazhdonte të më kthehej në mendje dhe, çdo herë, dëgjoja rendin e fjalëve të

shqiptuara, duke u përpjekur të zbuloja se çfarë ishte kaq intriguese tek to. Ishte diçka që lidhej me kohën, e ndjeja, diçka që lidhte "shumë vjet më vonë" me "pasdite e largët" dhe diçka për mënyrën befasuese në të cilën folja kryesore ishte dhënë. Fjalja e plotë, në përkthim është kjo: "*Shumë vjet më vonë, përballë togës së pushkatimit, kolonel Aureliano Buendía-s do t'i kujtohej ajo pasdite e largët kur i ati e çoi të shihte akullin*". Dhe, sigurisht, duhet ta kemi në origjinalin spanjisht: *Muchos años después, frente al pelotón de fusilamiento, el coronel Aureliano Buendía había de recordar aquella tarde remota en que su padre lo llevó a conocer el hielo*.

Do të kthehem tek kjo fjali, por, para se ta bëj, desha të rrëfej një përvojë tjetër të vogël, diçka që më ndodhi kohët e fundit - vetëm disa vjet më parë. Jetoja në Londër sikur tani, e martuar, me fëmijë dhe duke u përpjekur të shkruaj. Kisha kohë që rreksha të shkruaja, me rezultate të ndryshme. Ndoqa një kurs për të shkruarit dhe mësuesja foli për kohën. "Koha", tha ky mësues, "shkon në një drejtim. Përpara, jo mbrapa". Ishte mësuese shumë e mirë; ajo që po thoshte ishte e vërtetë e padiskutueshme dhe pyesja veten se si s'e kisha vënë re një fakt kaq të rëndësishëm dhe të dukshëm; kuptova se një vetëdije më e madhe për këtë fakt, do të ma përmirësonte shumë të shkruarit. "Në të vërtetë", vazhdoi ajo, "thjesht duhet të shohim stinën, gjethet që bien në vjeshtë, për t'u kujtuar për kalimin e kohës".

Ky ishte çasti kur më ndodhën shumë gjëra

njëherësh. Së pari: ajo fjali dhe paraqitja e pazakontë e kohës prej saj. Së dyti, që García Márquez-i ishte nga tropikët, si unë. Së treti, që në tropik s'kemi katër stinë, në fakt, mund të thuhet se thjesht s'kemi fare stinë. "Ajo që po thoni nuk vlen për ne në tropikë", mendova. "Koha është ndryshe për ne".

Këtë e vini re kudo në krijime letrare: kalimi i kohës tregohet nga ndryshimi i stinëve, autorët na tregojnë se vera kthehet në vjeshtë dhe dimri kthehet në pranverë si mjet për të treguar kalimin e kohës, çdo stinë me simbolikën e saj përkatëse. Tani që kam jetuar për një kohë kaq të gjatë në klimë të butë, e kuptoj përhapjen e saj. Ndërsa po shkruaj tani, për shembull, është dimër: është gati ora katër, tashmë është errur, kam qenë e zënë gjithë ditën, s'kam dalë jashtë për shëtitje, dhe tani dita ka përfunduar! E megjithatë muajt e dimrit duket se zvarriten, mezi presim kthimin e pranverës. Vera krijon një ndjenjë qëndrueshmërie, sikur mund të vazhdojë përgjithmonë, por shumë shpejt gjethet nisin të zverdhën, pastaj bien nga pemët, dhe sërish ndërsa ecën në rrugë, mendon, "Sa hap e mbyll sytë! Iku edhe një vit!".

Në vendet me klimë të butë, bota po zhvendoset vazhdimisht para syve të tu: mjedisi të kujton vazhdimisht kalimin e kohës. Por nuk është kështu në të gjithë botën. Në tropik, s'ka vjeshtë. Nuk bien gjethet kudo. Nuk ka dimër apo pranverë. Mendoni për vendin nga vij, Trinidad & Tobago, një komb i vogël, me ishuj binjak, njëmbëdhjetë gradë në veri të ekuatorit, në brigjet e Venezuelës. Gjatë gjithë vitit është pak a

shumë, e njëjta temperaturë 80-90 ° F gjatë ditës. Çdo ditë të vitit, dielli lind rreth orës gjashtë të mëngjesit, është pingul mbi krye në mesditë, dhe perëndon rreth orës gjashtë e gjysmë të mbrëmjes.

Luhatja gjatë gjithë vitit shkon rreth njëzet minuta, aq pak sa ngjan sikur s’ka asnjë ndryshim, sikur çdo ditë është pak a shumë e njëjtë me një ditë më parë. Dita as nuk zgjatet dhe as nuk shkurtohet: është ditë ose natë, kaq e thjeshtë. Pemët kanë ritmet e tyre, por s’bashkrendohen me njëra-tjetrën. S’ka rënie masive të gjetheve, asnjë ndjesi vdekjeje apo rilindjeje. Përveç çështjes nëse bie shi apo ajo, çdo ditë është saktësisht e njëjtë me atë të mëparshme.

Në fakt, i vetmi ndryshim i vërtetë është shiu. Gjatë gjysmës së vitit, është shumë thatësi: e quajmë stinë e thatë. Gjatë gjysmës tjetër të vitit, bie me shi: e quajmë stinë me shi. Stinë e thatë, stinë me shi, stinë e thatë, stinë me shi: kështu është. Kështu, ritmi ynë është një - dy i thjeshtë: i lagësht - i thatë, ose ditë-natë. I thatë-i lagësht, ditë-natë, i thatë-i lagësht, ditë-natë, një-dy një-dy, pambarim, si goditja e pafund e metronomit. Dhe pastaj, sigurisht, kudo brenda perimetrit tonë gjeografike, është deti. Mendoni për këtë. Vala vjen, pastaj tërhiqet. Vjen, ikën. A mbaron ndonjëherë? A shihni ndonjë vdekje dhe rilindje? E thatë, e lagur, ditë, natë, brenda, jashtë. Jo, peizazhi ynë nuk sugjeron kalimin e kohës, siç bën peizazhi në klimën e butë. Peisazhi ynë sugjeron diçka krejt tjetër: përjetësinë e kohës, pafundësinë e pambarueshme të kohës.

Le ta shohim përsëri këtë fjali: *Shumë vjet më vonë, përballë togës së pushkatimit, kolonel Aureliano Buendía-s do t’i kujtohej ajo pasdite e largët kur i ati e çoi të shihte akullin*.

Ka shumë gjëra të mrekullueshme tek kjo fjali, por shtjellimi i kohës është ajo për të cilën desha të flisja. *Shumë vjet më vonë* lidh dy pika në kohë. Ka një kohë, le ta quajmë X, në të kaluarën, dhe koha *shumë vjet më vonë*, e quajmë Y. *Shumë vjet më vonë* i lidh këto dy pika dhe nënkupton rrugën e bërë midis tyre. Diçka që ka ndodhur ditën X është e lidhur me diçka që ka ndodhur ditën Y, dhe nëse imagjinoni sikur vendosni dy pika në një copë letër, njëra për të përfaqësuar ditën X dhe një tjetër për të përfaqësuar ditën Y, mund hiqni një vijë midis tyre, dhe vija që vizatoni është ekzistenca e saj, një ekzistencë e cila është një funksion i X dhe Y. Është sikur të kapërcesh njëpërmasoren e secilës prej atyre koordinatave duke u bërë informacion i një rendi më të lartë. Dhe mund ta përfytyrojmë pamjen e kësaj vije, vijën midis X dhe Y, si çdo lloj vije: mund të jetë vijë e drejtë, ose vijë me lakadredha, ose spirale. Çfarëdo që të jetë, ajo përshkruhet nga *shumë vjet më vonë*.

Tani, sigurisht, shumë shkrimtarë mund ta përdorin një frazë të tillë. Kur isha njëzet vjeçe, në një dyqan librash në Amsterdam, lexova rreshtin e parë të *Njëqind vjet vetmi*. Shumë vite më vonë, në të dyzetat, duke jetuar në Londër, e lexova përsëri. X është kur isha në të njëzetat, në Amsterdam; Y është kur isha rreth të dyzetave, në Londër. *Shumë vjet më vonë* përfaqësojnë njëzet e ca vjet që kanë kaluar midis dy ngjarjeve. Por a na jep fjalia ndonjë sugjerim se ka diçka të veçantë në periudhën e njëzet e ca viteve? A mund të zëvendësojmë “të nesërmen” ose “disa muaj më vonë” ose “një vit më vonë”? Mendoj se mundemi. Mendoj se ka një mundësi që autori i këtyre fjalive (në këtë rast, unë) të kthehet dhe t’i japë kuptim *shumë vjet më vonë*, por deri më tani, s’ka asgjë për të sugjeruar se ka ndonjë gjë të veçantë në atë periudhë të veçantë kohore. Pra, gjithçka që kemi është:

Diçka ndodhi.

Koha kaloi.

Diçka tjetër ndodhi.

S’ka asgjë të keqe këtu, shkruaj gjëra të tilla gjatë gjithë kohës, dhe kështu bëjnë shumë shkrimtarë të tjerë. Ajo që dua të them është se të përdorësh frazën “shumë vjet më vonë” s’është në vetvete shkëndijë gjeniale.

Atëherë, çfarë ka bërë ndryshe García Márquez-i? Kini parasysh frazën tjetër: *përballë togës së pushkatimit* – këtu fillojnë gjërat të bëhen pak të çmendura. Së pari, ja ku jemi, në rreshtin hapës të një romani (një romani të gjatë), dhejemi krah për krah me personazhin që përballlet me një skuadër pushkatimi. Në një çast je në kolltukun e rehtashëm në dhomën e ndenjes, mbase me një filxhan çaj pranë teje, le të themi ndanë zjarrit që kërcet në vatër, macen e ke tek këmbët; në çastin tjetër: skuadra e pushkatimit. Së dyti, na bëhet e njohur diçka që zakonisht është e panjohur, çasti i vdekjes së dikujt. Menjëherë zhvendosemi në territorin paksa surreal të gjithëdijes: kjo do të thotë, njërën këmbë e mbajmë në realitet, sepse, me siguri, një skeptik mund të theksojë në mënyrë të arsyeshme se vdekja e këtij personazhi është aq e afërt sa ai e sheh duke ardhur; por këmba tjetër s’është aq e rrënjësuar në realitet, sepse të parashikosh çastin e vdekjes tënde ns’është aspak pjesë e ekzistencës sonë normale.

Më pas, vijmë tek *do t’i kujtohej*, ndonjëherë përkthyer si *do të kujtonte*. Ku jemi në kohë? A jemi në X apo Y? Në çastin kur personazhi është duke kujtuar ndodhemi në kohën Y, por *do t’i kujtohej* duket se na vendos diku jashtë kohës Y, madje na lë pezull krejtësisht jashtë kohës.

Në fund të fjalisë, gjejmë X-në, e cila përmbush *shumë vjet më vonë*, që kemi hasur në fillim: *atë pasdite të largët kur i ati e çoi të shihte akullin*. Më vonë në kreun e parë, zbulojmë se akulli është në të vërtetë akulli që bartet në një arkë të ftohtë nga një cigan, por në këtë fjali hapëse, mund të jetë çdolloj akulli - mund të jetë një akullnajë e stërmadhe dhe e lashtë. Fakti që është babai që e merr djalin për të “zbuluar” diçka lë të nënkuptohet diçka të lashtë, diçka edhe

më tej se “pasditja e largët” dhe të krijon përshtypjen e njohurive të brezave të mëparshëm që shtresëzohen në kohë. (Spanjishtja është “conocer”, e cila nganjëherë përkthehet si “marr për të parë për herë të parë”, por gjithashtu do të thotë “të njihesh me dikë” si të takosh një person, ose “të njihesh me të” ose “ta njohësh dikë”. “Zbuloj” është sigurisht një zgjedhje shumë e bukur në anglisht.)

Pra, në fund të fjalisë, ato tri fjalët e para, *shumë vjet më vonë*, kumbojnë në heshtje me kuptim të shtuar, sepse përmbajnë pothuajse shumën totale të jetës së këtij njeriu, që ka arritur gati në fundin e saj. Ka një patos në këto fjalë që përshkruajnë një personazh në çastet e fundit, duke u zhvendosur njëkohësisht pas në këtë hapësirë të madhe kohe - dhe kjo, në vetvete, është kapërcim kohe - dhe, nga ana tjetër, ka njohuri të plotë për të ardhmen e tij. E gjitha kjo është kapur në këtë fjali të vetme, elegante, në këtë çast të shkurtër kur ai është në gjendje të shohë tërë kohështrirje të jetës së vet, nga skaji në skaj.

Që atëherë kam vazhduar të lexoj pak më shumë nga García Márquez-i, dhe vetëm nëpërmjet leximit të thellë të disa prej veprave të tij të tjera kam kuptuar më mirë se pse kjo fjali e veçantë më bëri një përshtypje të tillë. Hipoteza ime është se García Márquez-i paraqet një konceptim alternativ të kohës, të kohës jo thjesht si diçka lineare, por edhe si diçka që s’mbaron kurrë.

Në një kuptim, natyrisht, mësuesja ime kishte shumë të drejtë të thoshte se koha lëviz në një drejtim, përpara dhe jo prapa; askush nga ne s’mund të kthehet kurrë në një çast të kaluar për ta bërë ose zhbërë, për të thënë diçka apo për ta ç’thënë. Është ligj që rregullon gjithë jetën tonë, dhe nëse krijimi letrar në një farë mënyre pasqyron atë që është njerëzore, atëherë edhe krijimi letrar duhet t’i bindet këtij ligji. Në të vërtetë, tani që më janë hapur sytë ndaj këtij fakti, vërej vazhdimisht se krijimet e mira letrare e respektojnë këtë ligj, dhe krjimet e dobëta e shpërfillin. García Márquez-i bindet. Ai bën sikur bindet më shumë sesa bindet: i qëndron gati tu, e përshëndet - dhe më pas

i shkel syrin. Sepse, në të njëjtën kohë arrin të paraqesë një nocion alternativ të kohës, atë që mendoj se sugjerohet nga klima tropikale: koha si e pafund. Kudo në historitë e tij, shohim nocione rrethore, të përsëritjes së pafund të cikleve. Kam lexuar më shumë vëmendje disa nga veprat e tij duke i shqyrtuar imtësisht, duke nënvizuar fjali për të vëzhguar nëse i referohen të ardhmes apo të kaluarës dhe s’jam befasuar shumë nga modeli i shfaqur, e ardhmja – e kaluara, e ardhmja - e kaluara, e ardhmja - e kaluara... para - prapa, para – prapa të një metronomi që godet. Pikërisht siç bën në fjalinë e parë të *Njëqind vjet vetmi*, shpesh García Márquez-i shkruan sikur të kishte një lloj barazlartësie ndaj të kaluarës dhe të ardhmes, gati sikur të mos kishte asnjë shigjetë përpara kohës.

Për mua si shkrimtare në mes të rrugëtimit krijues, mënyra si e shtjellon kohën García Márquez-i është magjepsëse dhe emocionuese. Ka, mbase, “rregulla” për të shkruar mirë - e megjithatë ja ku kemi një shkrimtar që s’u kufizua në hapësirën e përcaktuar nga këto rregulla. Këto rregulla mund të jenë përcaktuar, pa dashje, në mënyrë të padukshme, nga një pjesë e caktuar e botës dhe ja ku janë sfiduar nga dikush në një pjesë tjetër të botës, një pjesë e botës nga e cila vij edhe unë. Më jep njëfarë besimi. Më krijon ndjesinë se gjithçka është e mundur.


Përktheu: Granit Zela`



UVIL ZAJMI

UNË, BELUL MEGALOMANI I SPORTIT

Humor



Unë, Belul megalomani i sportit”, është libri i ri që publicisti Uvil Zajmi, ka përgatitur dhe shpejt do të dalë në treg. Një libër humoristik, pak ndryshe me botimet, stilin e tij, që ai tashmë ai i ofron lexuesve. Sipas autorit, idea, përmbajtja i referohet një figurë humoristike e ngjashme me atë komike të Belul Gjiraqinës të Qamil Buxhelit, por në këtë rast, bëhet fjalë për një tjetër personazh, një Belul megaloman, fodull të sportit. Shumë i ditur, i gjithanshëm në këtë

fushë, kritikues e që të godet për gjithcka, një figurë e sjellë me humor që flet për karrierën e tij, që komunikon me lexuesit, i përgjigjet letrave të tyre, që jep mend, këshilla, orientime, etj. Ndonëse i ardhur, i trashëguar nga sistemi që i shërbeu për shumë vite, sot shfaqet me të tjera ngjyra, një Belul megaloman e fodull i kohëve moderne që sipas Zajmi nuk i referohet askushit, as dikushit, as tjetërkushit, as shumkushit.